



Tregu i Përbashkët Rajonal dhe nisma Ballkan i Hapur

Analizë krahasuese për vendet e Ballkanit Perëndimor

Grupi i punës:

Enton Duro Klodian Muço Altin Hoti

Janar 2022

Akademia e Studimeve Politike

Rruga "Emin Duraku", Pallati Credins Hyrja 1, kati 7, Ap. 21, Tiranë,

Tel: +355 4 5629047, E-mail: info@asp.al, Web: www.asp.al

Ky dokument u prodhua si pjesë e kontributit profesional të alumnëve të Akademisë së Studimeve Politike (ASP) mbi reformat dhe zhvillimin e politikave të rëndësishme në vend. Akademia krenohet me rrjetin alumni - mbi 370 pjesëmarrës të pesëmbëdhjetë gjeneratave - përfaqësues të partive politike, administratës publike, shoqërisë civile, botës akademike dhe medias, të cilët kanë ndjekur programin që prej krijimit të tij në vitin 2007.

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të donatorëve dhe organizatës mbështetëse.

Copyright ASP 2022

Përmbajtja

1.	Konteksti	5
2.	Qëllimi i punimit.....	5
3.	Metodologjia dhe burimi i të dhënave	6
4.	Literatura mbi hapjen tregtare	7
5.	Gjetjet kryesore të analizës sasiore	8
6.	Proceset ndërvepruese të BP6 si dhe integrimi drejt BE.....	11
7.	Përfundime dhe masat e propozuara për politikëbërësit.....	14
8.	Shtojcë: Analiza kërkimore sasiore	17
8.1.	Rritja ekonomike, ndarja sektoriale, produktiviteti dhe tregu i punës.....	18
8.2.	Dallimet në Financat Publike, të Ardhurat dhe Shpenzimet dhe Borxhi Publik.....	22
8.2.1.	Normat tatimore në BP6.....	25
8.3.	Kreditimi i sektorit bankar dhe tregues të tjerë lidhur me sistemin bankar për BP6	26
8.4.	Sektori i Jashtëm, Tregtia, IHD, Llogaria Korrente dhe borxhi i Jashtëm	28
8.4.1.	Tregtia e mallrave në BP6	28
8.4.2.	Disa nga problematikat e tregtisë së mallrave të PB6	32
8.4.3.	Llogaria Korente dhe IHD	32
8.4.4.	Borxhi i jashtëm	34
8.5.	Të Bësh Biznes dhe Novacioni.....	35
	Referenca	38

Lista e Tabelave

Tabela 1	Indeksi i Korrupsionit dhe renditja për periudhën 2017- 2021	13
Tabela 2	Informacion për BP6.....	17
Tabela 3	Treguesi i rritjes ekonomike për BP6	18
Tabela 4	Pjesëmarrja sektoriale (%) në Vlerën e Shtuar Bruto, mesatare 2016-2019.....	19
Tabela 5	Të Ardhurat buxhetore në përqindje të PBB, mesatare 2016-2019	23
Tabela 6	Shpenzimet buxhetore në përqindje të PBB, mesatare 2016-2019	24
Tabela 7	Projeksionet për Borxhin Publik dhe Balancën Buxhetore për vitin 2021.....	25

Tabela 8 Normat tatimore për vitin 2021	25
Tabela 9 Firmat që përdorin sistemin bankar në përqindje të totalit, viti 2013 vs. 2019	26
Tabela 10 Tregues të sistemit Bankar gjatë periudhës 2016-2020	27
Tabela 11 Tregtia ndërrajonale e mallrave në BP6, viti 2019	28
Tabela 12 Hapja dhe balanca tregtare si dhe import eksport sipas hapësirave gjeografike në përqindje të PBB, viti 2019	29
Tabela 13 Krahasim 2019 vs. 2011 të tregtisë së mallrave për BP5 (rritja në %)	30
Tabela 14 Tregtia ndërkombëtare sipas grupeve kryesore në përqindje të PBB, viti 2019	31
Tabela 15 Përbërja e borxhit të jashtëm në vitin 2020, në përqindje të PBB	34
Tabela 16 Indeksi “Të bësh biznes” dhe renditja për çdo nëndarje të tij në vitin 2020	35
Tabela 17 Indeksi i Novacionit Global dhe renditja për çdo nëndarje të tij në vitin 2021	36

Lista e Grafikëve

Grafiku 1 Produktiviteti për të punësuar si dhe paga mesatare, viti 2019	19
Grafiku 2 Dinamika e pagës mesatare në BP6 gjatë periudhës 2012-2019	20
Grafiku 3 Norma e papunësisë sipas statistikave kombëtare dhe ILO, viti 2019	21
Grafiku 4 Struktura e të punësuarve, viti 2019	21
Grafiku 5 Kredia e brendshme drejt sektorit Privat, në përqindje të PBB	27
Grafiku 6 Llogaria korente në përqindje të PBB ndër vite për PB6	33
Grafiku 7 Investimet e Huaja Direkte (hyrjet neto) në përqindje të PBB ndër vite për PB6	34
Grafiku 8 Rënditja në Indeksin e Kompleksitetit Ekonomik, periudha 2009-2019	37

1. Konteksti

Vendet e Ballkanit Perëndimor (BP6) të përfaqësuar nga Shqipëria, Bosnja Hercegovinë, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, janë të vetmet vende që kufizohen territorialisht nga Bashkimi Evropian (BE) dhe ende nuk janë pjesë e tregut të përbashkët evropian. BP6 janë vende drejt zhvillimit dhe tashmë kanë shprehur gadishmërinë për të qenë pjesë e BE duke u angazhuar në shumë nisma institucionale dhe politike drejt integritit në BE duke promovuar standart më të mirë jetese dhe rritje ekonomike të begatë, gjithëpërfshirëse dhe cilësore.

Hapat konkretë drejt integritit evropian të këtyre vendeve shihen me firmosjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) midis çdo vendi dhe BE, e cila është pasuar edhe me nisma të tjera bashkëpunimi konkret, ndër to, Marrëveshja e Tregtisë së Lirë për Evropën Qendrore (CEFTA), e cila u jep mundësinë vendeve të BP6 për të arritur marrëveshje të Tregtisë së Lirë Ndër-rajonale duke eliminuar gradualisht barrierat tarifore dhe jotarifore.

Një nismë e rëndësishme në aspektin e arritjeve të përbashkëta tek vendet e BP6 është dhe “Procesi i Berlinit” në vitin 2014. Ky angazhim i udhëhequr nga Gjermania, nëpërmjet kancelares Angela Merkel, synon mbështetjen e rajonit për zhvillimin në sferat e “pajtimin, stabilizimit, sektorit energjetik, sundimit të ligjit, ekonomisë së tregut dhe të shtetndërtimit”. Agjenda e konektivitetit, e cila përfshin zhvillimin e infrastrukturës së transportit dhe energjisë, përmirësimin e lidhjeve rajonale dhe thjeshtimin e lëvizjes së mallrave dhe njerëzve, qëndron në thelbin e Procesit të Berlinit.

Si pjesë e këtij procesi, në samitin e Triestes në vitin 2017, u ndërmor edhe nisma e Zonës Ekonomike Rajonale (ZER), e cila do t’i jepte një impuls të ri përpjekjeve të BP6 drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian në mobilitetin e burimeve njerëzore dhe konvergjencën e standarteve dhe procedurave insitucionale, përthithjen dhe rritjen e investimeve, tregtinë dhe digjitalizimin.

Paqartësia e viteve të fundit e zgjerimit të mëtejshëm të BE, por dhe arsye të tjera, shtyu së fundi liderët e BP6 të kërkojnë zgjidhje optimale për situatën komplekse. Në vitin 2019, Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut hodhën idenë e krijimit të një Mini Shengeni Ballkanik. Në fund të korrikut 2021, kjo ide evoluoi në një nismë rajonale të tre vendeve, të quajtur “Ballkani i Hapur” me anë të së cilës është promovuar rritja e përfitimve ekonomike dhe sociale duke nxitur më tej lirinë e lëvizjes së mallrave dhe njerëzve si dhe bashkëpunimit në fusha të tjera me rëndësi të përbashkët. Ballkani i Hapur është përgjegjësi e vendeve antare në këtë nismë dhe nuk parashikon aktivizimin mbikqyrës të institucioneve të BE.

Përpjekjet e deritanishme të bashkëpunimit rajonal ekonomik në BP kanë ngjallur debate në retorikën politike të brendshme, por edhe skepticizëm të biznesit dhe aktorëve të tjerë në vendet respektive, mbi realitetin e ri të një tregu të përbashkët rajonal pa mbikqyrjen e BE në këtë proces.

2. Qëllimi i punimit

Përtej shumë paqartësive që ekzistojnë mbi nismën Ballkani i Hapur dhe nisma të tjera të bashkëpunimit rajonal, mbetet evident fakti që BP6 ka zhvillime të ndryshme apo asimetri të theksuara në profilin ekonomik dhe jo vetëm. Promovimi i ndërveprimit dhe konektivitetit të përshpejtuar të synuar nga Ballkani i Hapur dhe nismat e tjera të bashkëpunimit për një treg të përbashkët rajonal, duhet të bazohen mbi reduktimin e këtyre asimetrive si dhe një zhvillim të mëtejshëm ekonomik dhe social gjithëpërfshirës, duke rritur shanset e vetëarritjeve drejt standarteve të BE pa qenë nevoja e mbikqyrjes nga institucionet e BE.

Ky punim ka për qëllim të identifikojë asimetritë kryesore të ambientit ekonomik të vendeve të Ballkanit Perëndimor, cilat janë kapacitetet aktuale prodhuese dhe konkruuese si dhe madhësia e sektorit shtetëror në këndvështrimin e politikave tatimore dhe alokimit të shpenzimeve. Analiza e gjetjeve të hulumtimit synon që të ofrojë disa rekomandime për politikëbërësit mbi ndërhyrjet e nevojshme për të reduktuar këto asimetri dhe siguruar përfitime maksimale nga një treg i përbashkët rajonal si një parakusht për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe social në realitetin e ri të anëtarësimit në hapësirën e BE-së si dhe sfidave evidente të globalizmit.

3. Metodologjia dhe burimi i të dhënave

Punimi bazohet mbi analizën krahasuese të të dhënave për BP6. Në aspektin ekonomik baza krahasuese është fokusuar tek katër sektorët kryesorë: Sektori real; Sektori fiskal; Sektori financiar; dhe Sektori i jashtëm, por analiza pasurohet edhe me tregues të tjerë që lidhen direkt ose indirekt me sektorët e trajtuar. Në këtë kuptim mund të analizohen mbi bazë krahasuese burimet e disponueshme, konkrueshmëria dhe novacioni/teknologjia ku politik bërësit mund të kuptojnë më mirë asimetritë midis vendeve dhe nëse këto asimetri janë të natyrshme ose jo, si dhe cilat politika duhen ndjekur që rritja e ndërveprimit rajonal të mos çënojë avantazhet krahasuese aktuale të çdo vendi dhe mundësinë për ti zhvilluar më tej duke krijuar sinergji në zhvillimin ekonomik gjithëpërfshirës dhe cilësor të rajonit.

Burimet e informacionit sasior janë nga bazuar mbi baza të ndryshme të dhënash të cilat ofrojnë mundësinë e analizës krahasuese midis vendeve për treguesit në fokus të punimit. Përdorimi i disa burimeve të informacionit mund të çënojë koherencën e analizës krahasuese, pasi metodologjia e përdorur mund të jenë të ndryshme për burime të ndryshme, megjithatë, duke pasur në vëmendje këtë problematikë, nuk është tentuar të krahasohen të dhënat për të njëjtin argument nga burime të ndryshme informacioni. Kjo situatë ka ndodhur vetëm në ato raste kur kufizimi i informacionit nga një bazë të dhënash nuk plotëson analizën krahasuese, për shembull, rasti i Kosovës. Burimet e informacionit janë si më poshtë:

- Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ofron të dhëna mbi treguesit fiskal të qeverisë qendrore për të gjitha vendet e BP6 si dhe mbi borxhin publik. Bazuar në këto të dhëna

kuptohet se cila është pjesëmarrja e qeverisë në ekonomi si dhe mënyra e alokimit të shpenzimeve buxhetore¹.

- Banka Botërore ofron një gamë të gjerë treguesish në “World Development Indicator” (WOI) të cilët lidhen me tregues sasiore dhe cilësore në aspektin ekonomik dhe social të një vendi. Baza e të dhënave ofron mbi 1440 tregues, jo domosdoshmërisht të pranishëm për çdo vend, por në këtë punim janë përzgjedhur më përfaqësuesit në funksion të qëllimit të punimit.
- Të dhënat nga “Viena Institute for International Studies” (WiiW) mbi pagën mesatare në rajon janë shfrytëzuar si bazë krahasuese me nivelin e produktivitetit si dhe informacioni nga “Tradingeconomics” shërbeu për krasimin e normave të ndryshme tatimore të aplikuara në vendet e BP6.
- Përsa i përket të dhënave mbi tregtinë ndër-rajonale të mallrave është përdorur informacion nga “Atlas of Economic Complexity” i Universitetit të Harvard, pasi këto të dhëna janë të detajuara në nivelin e ndarjeve sipas nëngrupeve kryesore të produkteve dhe koherenca e të dhënave ruhet mirë. Megjithatë, kjo bazë të dhënash nuk ofron informacion për Kosovën, një kufizim i analizës së të dhënave mbi tregtinë e mallrave. Për këtë arsye, dhe për pasur një analizë krahasuese mbi të gjashtë vendet, është integruar informacioni i disponueshëm nga Agjencia e Statistikave në Kosovë që mund të ketë dallime metodologjike me “Atlas Economic Complexity” në ndërtimin e të dhënave, megjithatë ky proces nuk ka cënuar uniformitetin e të dhënave për vendet e tjera.

Analiza është shtrirë në segmente të ndryshme kohore, e cila në kënvështrimin e punimit, arrin të qartësojë më mirë diferencat e treguesve në analizë. Për shembull, analiza e tregtisë së jashtme është bazuar kryesisht në vitin 2019 pasi të dhënat e vitit 2020 humbin koherencën si rezultat i krizës pandemike të COVID-19 por edhe si rezultat i informacionit të disponueshëm. Në disa raste të tjera, interpretimi i të dhënave ndjek informacionin e disponueshëm edhe pas vitit 2019 duke ruajtur kontekstin krahasues. Për shembull, merr më shumë fokus se cili është niveli më i përditësuar i borxhit publik, borxhit të jashtëm etj.

4. Literatura mbi hapjen tregtare

Hapja tregtare çon drejt rritjes më të shpejtë ekonomike dhe reduktimit të varfërisë në vendet drejt zhvillimit (Dollar dhe Kraay, 2004). Tregtia ndërkombëtare mund të bëhen kanali kryesor i transferimit teknologjik (Almeida & Fernandes, 2008), duke rritur Produktivitetin Total të Faktorëve, megjithatë ky impakt mund të mos jetë simetrik në çdo rast. Për shembull, ekonomitë me fleksibilitet të lartë, veçanërisht në hyrjen e firmave të reja dhe përshtatshmërinë e kuadrit rregullativ tek biznesi mund të përftojnë më shumë nga hapja tregtare, në të kundërt, ekonomitë

¹ <https://taxsummaries.pwc.com/>

me fleksibilitet të ulët nuk e tregojnë këtë evidencë (Freud dhe Bolaky, 2008). Performanca e hapjes tregtare është lidhur me aftësinë e vendit për të diversifikuar prodhimin e të mirave (Hausmann et al. 2007) dhe kjo aftësi në vendet drejt zhvillimit është e kufizuar nga fazat e saj të zhvillimit. Natyrisht vendet drejt zhvillimit nuk mund të konkurojnë vendet e zhvilluara në maturitetin e ciklit të biznesit pavarësisht se këto vende duhet të orientohen drejt hapjes ekonomike e cila sjell gjithmonë përfitime. Për shembull, Sakyi et al. (2012) sugjeron se hapja tregtare në vendet me të ardhura të mesme bëhet më konkurruese në afat mesëm/gjatë duke qenë se vendet drejt zhvillimit rialokojnë burimet e ture ekonomike gjatë kësaj periudhe në mënyrë më efektive. Sidoqoftë, politik-bërësit, dhe pse nuk mund të rrijnë efektet e dëshiruara në afat-shkurtër, duhet të implementojnë politika me efekte pozitive në afat-gjatë. Lidhur me gjendjen social-ekonomike të zhvillimit, vendet drejt zhvillimit duhet marrin nisma konkrete në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe performancës së tyre, dhe kështu Hapja tregtare mund të sjell impakte pozitive në rezultatet e pritshme. Nën këtë leksion, Do dhe Levchenko (2006), gjejnë dy efekte të kundërta në hapjen ekonomike. Efekti i parë, i quajtur “efekti disiplinues i tregtisë”, sugjeron se firmat preferojnë performancë më të mirë institucionale të vendit në hapjen tregtare për të hequr dorë nga autarkia² dhe kjo preferencë vjen si rezultat i efektit në reduktimin e abuzimit të fuqisë tregtare dhe ndërhyrjes politike në proces. Efekti i dytë dhe më interesant, tregon se alokimi i fuqisë politike drejt firmave më të mëdha, duke përkeqësuar rishpërndarjen dhe cilësinë institucionale, sjell rreth vicioz përkeqësues në performancën ekonomike dhe institucionale të vendit dhe risqet për të arritur rezultate pozitive janë shumë të larta. Në fakt, ndërtimi institucional në filozofinë e mendimit neo-institucionalist vjen i lidhur ngushtësisht me besimin që gëzon shoqëria tek politik-bërësit dhe mungesën e riskut moral në politikë, duke e vendosur besimin si një nga faktorët thelbësor në zhvillimit.

5. Gjetjet kryesore të analizës sasiore

Referuar PBB për frymë, Kosova dhe Shqipëria janë vendet më të varfëra në rajon. Shqipëria është dhe vendi me nivelin më të lartë të varfërisë për personat që jetojnë me të ardhura nën 5.5 USD në ditë. Vendi me standarte më të mira në të ardhurat për frymë në rajon është Mali i Zi, i ndjekur nga Serbia. Gjatë periudhës 2013-2019, Mali i Zi është dhe vendi me performancën më të mirë të rritjes ekonomike në rajon.

Serbia është vendi me ekonominë më të madhe në rajon. Ekonomia e këtij vendi përballoi shumë më mirë se vendet e tjera të rajonit krizën e vitit 2020. Serbia rezulton me nivelin më të lartë të pjesëmarrjes së sektorit industrial (pëfshirë ndërtimin) në ekonomi, e ndjekur nga Maqedonia e Veriut dhe Bosnja Hercegovinë, ndërkohë që ekonomia Shqiptare rezulton me nivelin më të lartë të sektorit bujqësor në ekonomi. Kjo karakteristikë e ekonomisë Shqiptare, e shoqëruar me nivelin më të lartë të vetpunësimit në rajon, e bën vendin me nivelin më të ulët të produktivitetit

² Ekonomi e mbyllur.

në rajon dhe rrjedhimisht edhe të pagës mesatare. Ky trend vërehet gjatë një periudhe të gjatë kohore 2012-2019.

Mali i Zi është vendi me nivelin më të lartë të produktivitetit në rajon por edhe vendi me nivelin më të lartë të pjesëmarrjes së shërbimeve në strukturën e prodhimit. Kjo e fundit, si karakteristikë kryesore e ekonomisë së Malit të Zi, solli edhe pasojat më të rënda në rënien ekonomike krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Rënia ekonomike në Malin e Zi në vitin 2020 vlerësohet në -15.2%, ndërkohë që për Serbinë ky tregues për vitin 2020 vlerësohet vetëm -0.98%! Ekonomia e Serbisë është përfaqësuar me performancë më të lartë të rritjes ekonomike gjatë periudhës 2018-2020.

Serbia, Mali i Zi dhe Bosnje-Hercegovinë kanë pjesëmarrje më të lartë të shtetit në ekonomi, në mbi 40% të PBB, ndërkohë që Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut këtë pjesëmarrje e kanë në rreth 30% të PBB. Nga pikëpamja e përbërjes së shpenzimeve, ndër të tjera, vihet re niveli më i lartë i subvencioneve që realizojnë Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Ky tregues për Shqipërinë është rreth 17 herë më i ulët. Krahasimi midis të ardhurave totale buxhetore dhe të ardhurave nga taksat vë në pah varësinë e madhe që ka Kosova nga të ardhurat nga taksat në të ardhurat totale buxhetore. Diferenca është vetëm 2% e PBB për këtë vend. Ndërkohë që Serbia dhe Bosnja-Hercegovina e kanë këtë diferencë në rreth 20% të PBB. Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria janë vendet që realizojnë më pak të ardhura nga taksat në buxhetin e shtetit, në përqindje të PBB.

Edhe pse Shqipëria është vendi me normat më të larta tatimore të të ardhurave nga puna dhe kapitali, përsëri vendi aplikon nivelin më të ulët në rajon për kontributet shoqërore (përfshirë Kosovën). Maqedonia e Veriut ka një specifikë në këtë tregues pasi barra e sigurimeve shoqërore mbetet tek i punësuar duke krijuar më shumë hapësira për punëdhënësin. Vështirësia e sistemit tatimor në Shqipëri mund të përfaqësohet nga numri i lartë i pagesave vjetore, më i larti në rajon.

Kriza e Covid-19 ka prekur balancat buxhetore e të gjitha vendeve si rezultat i angazhimit të qeveritar në mbështetje të shoqërisë. Ndërkohë, niveli më i lartë i borxhit publik vihet re në Malin e Zi me rreth 93.4% të PBB, i ndjekur nga Shqipëria me rreth 81.4% të PBB. Borxhi i lartë publik në këto vende tregon dhe nevojën e arritjes së balancave buxhetore më shumë se në vendet e tjera për të ruajtur qëndrueshmërinë marko-fiskale dhe ulur riskun e borxhit publik në ekonomi.

Përdorimi i sektorit bankar në Shqipëri është më i ulëti në rajon, ndërkohë që Serbia ka dhe nivelin më të lartë në rajon për financimin e investimeve nga sektori bankar e ndjekur nga Maqedonia e Veriut. Duke përfshirë Kosovën, Maqedonia e Veriut dhe Serbia kanë dhe nivelin më të ulët të kredive me probleme në rajon, ndërkohë që Shqipëria ka nivelin më të lartë në këtë tregues. Shqipëria ka nivelin më ulët të kreditimit të sektorit privat në rajon gjatë periudhës 2012-2020.

Analiza e tregtisë së jashtme të mallrave tregon se Serbia është vendi me rezultatin më të mirë në rajon duke realizuar edhe një bilanc tregtar pozitiv me vendet e rajonit. Maqedonia e Veriut dhe Serbia janë vendet që kanë dhe nivelin më të lartë të eksporteve në rajon. Maqedonia e Veriut është vendi me hapjen më të lartë tregtare në rajon me rreth 135% të PBB e ndjekur nga Serbia me rreth 85% të PBB. Të dy vendet kanë dhe koeficientin më të lartë eksport/import në tregtinë e jashtme të mallrave duke treguar dhe specializimin e tyre në tregjet e eksportit. Ndërkohë Kosova dhe Shqipëria rezultojnë me nivelin më të ulët të hapjes tregtare në rajon. Kosova ka dhe koeficientin eksport/import më të ulët në rajon.

Partneri më i madh tregtar i rajonit mbetet BE. Në një analizë krahasuese midis vitit 2019 kundrejt vitit 2011, Shqipëria është vendi që ka rritur më shumë eksportet në rajon, ndërkohë që Maqedonia e Veriut është vendi që ka ulur më shumë eksportet dhe ka rritur më shumë importet në rajon. Serbia gjithashtu ka rritur eksportet dhe ka ulur importet në rajon, por kjo performancë është më e ulët se Shqipëria.

Nga pikëpamja e shportës së grupmallrave në tregtinë e jashtme vihet re niveli i lartë i eksporteve në “Makineri dhe Pajisje” i Maqedonisë së Veriut në 22.4% të PBB duke rezultuar eksportues neto në këtë grup. Nëse do të përjashtohet nëngrupi “Materiale ndërtimi dhe metale” Maqedonia e Veriut do të rezultonte me një bilanc tregtar pozitiv në tregtinë e jashtme. Serbia gjithashtu ka nivel të lartë të eksportit në “Makineri dhe Pajisje” dhe pse rezulton importues neto në këtë grup. Avantazhi i dukshëm në tregti për Serbinë është tek grupi “Ushqim, pije dhe duhan” ku rezulton si eksportues neto. Shqipëria, përveç rezultatit si eksportues neto në grupin “Tekstile dhe veshmbathje” është importues neto në të gjitha nëngrupet e tjera. Lidhur edhe me nivelin e ulët industrial eksporti në “Makineri dhe pajisje” për Shqipërinë është dukshëm më i ulët se mesatarja e rajonit. Mali i Zi është vendi me nivelin më të lartë të defiçitit tregtar në rajon i ndjekur nga Kosova duke treguar varësinë e lartë të këtyre vendeve nga tregjet e importit. Karakteristikë e përbashkët në tregtinë e jashtme për BP6 është pozicioni si importues neto i të gjitha vendeve në “Energji dhe hidrokarbure” duke treguar nevojën e kushtëzuar të rajonit nga tregjet ndërkombëtare.

Analiza e Llogarisë Korente të bilancit të pagesave tregon se vendet e BP6 përgjithësisht përmirësojnë balancat negative të tregtisë së mallrave me tregtinë e shërbimeve dhe rasti më tipik është Mali i Zi. Gjithashtu, niveli defiçitar i Llogarisë Korente lidhet me IHD që kanë tërhequr vendet e BP6. Në këtë aspekt Mali i Zi është vendi me nivelin më të lartë të IHD gjatë periudhës 2008-2019 dhe pse ky tregues ka ardhur në rënie. Shqipëria ka ruajtur nivel të kënaqshëm të IHD gjatë kësaj periudhe, krahasuar me vendet e BP6, por Maqedonia e Veriut dhe Serbia tregojnë se gjatë periudhës 2016-2019 niveli i IHD ka një trend rritës krahasuar me periudhën pararendëse, fenomen që nuk vihet re tek vendet e tjera.

Mali i Zi është edhe vendi me nivelin më të lartë borxhit të jashtëm i cili është mbi 2 herë vlera e PBB së vendit. Ky tregues lidhet edhe me specifikat e evidentuara më sipër për Malin e Zi si borxhi i lartë publik.

Maqedonia e Veriut është vendi me klimën më të mirë të bërit biznes në rajon. Vendi renditet në 17 vendet e para nga 190 vende të klasifikuara në këtë indeks, performancë shumë e lartë nëse e krahasojmë me renditjen e 82 të Shqipërisë dhe 90 të Bosnje Hercegovinës. Nga 10 kolonat e vlerësimit në përbërje të indeksit, Shqipëria ka 7 prej tyre nën mesataren e rajonit. Serbia gjithashtu ka një klimë më të mirë se Shqipëria në të bërit biznes. Vendi renditet i 44 në klasifikimin total.

Indeksi Global i Inovacionit rendit Malin e Zi në vendin e parë në rajon, i ndjekur nga Serbia dhe Maqedonia e Veriut. Edhe në këtë tregues Shqipëria renditet e fundit në rajon e ndjekur nga Bosnje Hercegovinë.

Performancë e ulët për Shqipërinë shihet edhe tek Indeksi i kompleksitetit ekonomik, krahasuar me rajonin. Ky tregues nuk është përmirësuar ndër vite për Shqipërinë, ndërkohë që vendet e tjera të rajonit po përmirësojnë klasifikimin e tyre në këtë indeks. Klasifikimi më i mirë në rajon i mbetet Serbisë e ndjekur nga Bosnje Hercegovinë dhe më pas Maqedonia e Veriut.

Indeksi i perceptimit të korrupsionit për vitin 2021 rendit Shqipërinë në vendin e fundit në rajon së bashku me Bosnja Hercegovinë. Ky tregues ka ardhur në përkeqësim për Shqipërinë gjatë katërvjecarit të fundit.

6. Proceset ndërvepruese të BP6 si dhe integrimi drejt BE

Vendet e BP6 kanë qenë në vijimësi vende të me problematika të theksuara në bashkëpunimin rajonal. Pesë nga këto vende kanë qenë pjesë e ish-Republikës Federale të Jugosllavisë e cila arriti shpërbërjen e saj graduale gjatë periudhës 1992-2006. Trashëgimia e ish-Republikës Federale të Jugosllavisë duket se i ka mbetur Republikës së Serbisë por pakicat serbe në vende të ndryshme të ish-federatës ende kanë ndikim në vendet përkatëse. Kështu mund të përmendim Republikën Serbe në Bosnje Hercegovinë, komunitatet me shumicë serbe në veri të Kosovës të cilat kanë garantuar edhe pjesëmarrje në parlamentin e Kosovës, minoriteti Serb në Malin e Zi i cili është përfaqësuar edhe me grupime politike si dhe një pakicë në Maqedoninë e Veriut me rreth 1.7% të popullsisë totale. Edhe pse në Serbi ka minoritete të kombësive të tjera, si Boshnjakë, Malazezë, Shqipëtarë dhe Maqedonas, përsëri nuk vihet re e njëjta përfaqësi si dhe pakicat serbe në vendet e sipërpërmendura. Kjo situatë ka prodhuar ngjarje politike konfliktuale në vijimësi në çdo vend dhe pse me dimensione të ndryshme të cilat, e parë në këndvështrime të ndryshme, interpretohen si konflikte etnike por dhe e drejta për të respektuar minoritetin dhe përfaqësinë e tyre në vendimarrjet politike të vendit. Për më tepër, Republika e Kosovës ende vijon një konflikt real me Republikën e Serbisë për njohjen saj me të drejta të plota si një vend i pavarur dhe me sovranitet të plotë.

Të rrethuar territorialisht nga kufijtë e BE, por ende jo pjesë e saj, BP6 natyrshëm tërheq vëmendjen e vazhdueshme të BE dhe insitucioneve të saj. Kjo vëmendje nuk ka qenë gjithmonë e tillë. Në fakt, BE rriti vëmendjen e tij drejt BP gjatë luftës së Kosovës në vitin 1999, dhe me futjen në BE të Kroacisë e Slovenisë në vitin 2004, vende që u shkëputën nga ish Republika Federale e Jugosllavisë gjatë shpërbërjes së saj, dhe Bullgarisë e Rumanisë në vitin 2007, kjo vëmendje është intesifikuar. MSA e ratifikuar tek të gjitha vendet e BP6 ka nxitur përmirësime strukturore me adaptimet graduale të “Acquis communautaire” duke promovuar parimet demokratike dhe shtetin e të drejtës si dhe lëvizjen e lirë të mallrave, njerëzve dhe kapitalit. BE nuk e ka parë procesin e intergrimit si një marrëdhënie njëvektoriale midis BE dhe vendit kandidat por edhe si një rezultat domethënës në bashkëpunimin rajonal të gjithanshëm midis vendeve të BP6. Bashkëpunimi rajonal rrit kapacitetet ndëverpuese të vendeve forcon ekonominë e tyre dhe i bën më konkurruese drejt tregut të BE, si dhe redukton marrëdhëniet konfliktuale. Disa vlerësime të BB (2019) tregojnë që bashkëpunimi rajonal mund të rris me 2.5% nivelin e PBB për vendet e BP6. Për më tepër marrëveshjet e CEFTA ka eliminuar barrierat tarifore midis vendeve të BP6 duke ndihmuar në tregtinë e mallrave për këto vende edhe pse pengesat me barrierat jo-tarifore ende janë prezent.

Një tjetër nismë e vendeve të BE për intesifikimin e bashkëpunimit rajonal në BP6 dhe zgjidhjen e krizave midis tyre është dhe Procesi i Berlinit i inicuar në vitin 2014 nën drejtimin e Gjermanisë. Ky proces asiston vendet e BP6 në tre forume kryesore: Shoqëria civile; Biznesi; dhe Të rinjtë; duke rritur ndërveprimin dhe lidhjet(konektivitetin) midis tyre. Nisur nga procesi i Berlinit, në samitin e Triestes 2017, u inicua edhe nisma e Zonës Ekonomike Rajonale (ZER) për BP6 e cila do të ti jepte një impuls të ri përpjekjeve të BP6 drejt anëtarësimit në BE në mobilitetin e burimeve njerëzore dhe konvergjencën e standarteve dhe procedurave insitucionale, përthithjen dhe rritjen e investimeve, tregtinë dhe digjitalizimin. Më pas kjo ide u zgjerua më tej në iniciativën e Tregut të Përbashkët Rajonal në 2020 duke shtuar elementin social-ekonomik dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor si dhe inovacionin. Në vitin 2021 është hartuar edhe Plani i Veprimit drejt Tregut të Përbashkët Rajonal 2021-2024 që mbulon katër hapësira kryesore:

- Hapësira e tregtisë rajonale: lëvizje e lirë e mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve duke përfshirë dhe zgjerimin e korsinë e gjelbër;
- Hapësira e investimeve rajonale, për të linjësuar politikat e investimeve në përshtatje të standarteve të EU dhe promovimit të IHD;
- Hapësira rajonale digjitale për të integruar PB6 në hapësirën e tregut digjital të BE;
- Hapësira industriale dhe inovacionit rajonal për transformimin e sektorëve industrial, formëzimin e zinxhirit të vlerës përkatëse dhe përgatitja për sfidat e të ardhmes.

Këto nisma do të shoqërohen me ndihmë financiare për investime në BP6 nga Komisioni Evropian (KE) në 9 Miliardë euro për periudhën 2021-2027³ e cila mund të arrij deri në 20 miliardë euro nëse integrohet me investime private dhe publike nga vendet dhe mbështetet nga instrumenti i garancisë dhe facilitetit për vendet e BP6.

Në çdo kohë BE ka shprehur qartazi se rezultatet e bashkëpunimit rajonal kërkojnë vullnet të fortë politik me integritet dhe luftë të pandalshme ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në prezencë të këtyre faktorëve dominues, efektiviteti i çdo nisme mbetet i cunuar dhe krijon rreth vicioz në mungesën e arritjeve të ardhshme. Ky mesazh i BE merr kuptim kur shohim të dhënat mbi Indeksin e Korrupsionit.

Tabela 1 Indeksi i Korrupsionit dhe renditja për periudhën 2017- 2021

	2021		2020		2019		2018		2017	
	CPI	Renditja	CPI	Renditja	CPI	Renditja	CPI	Renditja	CPI	Renditja
ALB	35	110	36	104	35	106	36	99	38	91
BIH	35	110	35	111	36	101	38	89	38	91
KOS	39	87	36	104	36	101	37	93	39	85
MNE	46	64	45	67	45	66	45	67	46	64
MKD	39	87	35	111	35	106	37	93	35	107
SRB	38	96	38	94	39	91	39	87	41	77

Burimi: Transparency International, 2022

Në këtë indeks janë renditur 180 vende të botës dhe indeksi për vitin 2021 merr vlera reale nga 88 në 11. Sa më e lartë vlera aq më pak perceptim të korrupsionit ka në vend. Referuar të dhënave në Tabelën 1, Shqipëria mbetet vendi me nivelin më të ulët të indeksit për vitin 2021 dhe kjo vlerë ka ardhur në rënie gjatë periudhës 2017-2021. Shqipëria renditet në vendin e 110 për nivelin e indeksit nga 180 vende për vitin 2021. Përmirësim të dukshëm vihet re në Maqedoninë e Veriut dhe në Kosovë, ndërkohë që Mali i Zi mbetet vendi me nivelin më të lartë të indeksit (më të ulët të perceptimit të korrupsionit) për periudhën e marr në konsideratë.

Ndoshta e kushtëzuar nga ngjarje të parpitura, si vendosja e taksës 100% nga ana e Kosovës për produktet serbe dhe veto e Bullgarisë në BE për të pranuar hapjen e negociatave të vendit kandidat për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, tre vende të ballkanit perëndimor: Shqipëria; Maqedonia e Veriut; dhe Serbia, inicuan “Ballkanin e Hapur”, një nismë ku vendet e tjera të BP6 po hezitojnë të bëhen pjesë. Ideuesit e nismës, e cilësojnë atë si një plotësim të mëtejshëm të “Procesit të Berlinit” dhe nismave të tjera të bashkëpunimit rajonal. Pavarësisht se Bosnja Hercegovinë, Kosova dhe Mali i Zi po shprehin skepticizëm për të qenë pjesë e kësaj nisme, 3 vendet iniciatore nënshkruan në Dhjetor 2021 në Elbasan marrëveshjet e para të Ballkanit të Hapur. Më konkretisht, një marrëveshje për lejet e ndërsjellta të punës; marrëveshjen për integrimin e sistemeve elektronike, duke u mundësuar qytetarëve të paraqesin aplikime në

³ “Economic and Investment Plan for the Western Balkans”

vende të tjera, si dhe katër marrëveshje lidhur me inspektimet veterinarë dhe fitosanitare, të cilat do të lehtësojnë marrëdhëniet tregtare në fushën e blegtorisë, si dhe të produkteve me origjinë bimore dhe shtazore.

Lidhur me deklaratat politike të Kosovës mbi pjesëmarrjen në Ballkanin e Hapur mund të kuptohet qartazi që pozicioni institucional i Qeverisë së Kosovës refuzon të dakortësojë marrëveshje me aspekt ekonomik në mungesë të mos njohjes së Republikës së Kosovës si vend i pavarur dhe me të drejta të plota nga Serbia. Deklarat e leadership-it të Kosovës japin mendimin se Procesi i Berlinit është mjaftueshëm përfaqësues për të arritur objektiva të përbashkëta në rajon duke refuzuar nismën Ballkan i Hapur. Qeveria e Kosovës dhe Qeveria Shqiptare gjatë fundit të vitit 2021 çuan më tej një sërë marrëveshjesh bilaterale frytdhënëse dhe Kosova e shpreh qartazi se marrëdhënia me Shqipërinë është në projektet e saj strategjike të cilat duhen konsoliduar intensivisht dhe pa influenca nga vendet e tjera të BP6. Nga ana tjetër Mali i Zi pretendon se nisma Ballkan i Hapur nuk do të ketë impakt në procesin e anëtarimit të vendit në BE dhe nuk sheh të nevojshëm pjesëmarrjen e tij në këtë nismë edhe pse shpreh vullnetin për të qenë pjesë e tryezave të diskutimit pa vendim-marrje. Të tre vendet jo-pjesëmarrëse janë të mendimit se marrëveshjet e CEFTA dhe ndoshta edhe të procesit të Berlinit, janë mëse të majftueshme për çuar përpara bashkëpunimin rajonal dhe lirinë e lëvizjes së mallrave. Duhet të kujtojmë se vendet e BP6 nuk aplikojnë barrierë tarifore për tregtinë e mallrave nën marrëveshjen e CEFTA.

Megjithatë, mbetet ende paqartë për publikun e gjerë dhe grupet e interesit se në cilat specifika do të shtyhet më shumë Ballkani i Hapur dhe cilat janë specifikat që BP6 nuk ka arritur ti adresoj apo dhe zgjidh në tryezat e përbashkëta me insitucionet e BE, si dhe ku qëndron vështirësia e adresimit të tyre në prezencën e insitucioneve të BE. Në këtë kuptim, analiza e mundësive reale dhe praktike për vendet në nismën Ballkani i Hapur, e krahasuar me mangësitë e deritanishme të Procesit të Berlinit dhe arsyet pse ky proces nuk ka dhënë arritjet e pritshme duhet të jetë baza e komunikimit transparent me shoqërinë dhe biznesin bazuar në analiza të qarta teknike dhe politike.

7. Përfundime dhe masat e propozuara për politikëbërësit

Gjetjet e ofruara nga ky punim dëshmojnë ekzistencën e asimetrive në strukturën ekonomike të vendeve të BP6. Në përgjithësi, Serbia dhe Maqedonia e Veriut janë të pozicionuar më mirë në të gjithë treguesit e marrë në konsideratë në këtë punim. Ekonomitë e tyre janë më shumë të orinetuara drejt prodhimit industrial dhe kohët e fundit performanca e tyre po rritet. Ky fenomen nuk identifikohet në ekonominë Shqiptare. Kjo e fundit ka dhe peshën më të madhe të pjesëmarrjes së sektorit bujqësor në ekonomi si dhe nivelin më të ulët të produktivitetit në rajon bazuar tek të dhënat e disponueshme. Shpenzimet buxhetore për subvencione në përqindje të PBB janë shumë më të larta se në Shqipëri dhe efektiviteti i tyre mund të vihet re në përmirësimin

e kompleksitetit të eksporteve, klimën e të bërit biznes dhe në inovacion duke impaktuar pozitivisht në konkurrueshmërinë e vendit në tregjet ndërkombëtare. Niveli i lartë i normave tatimore në Shqipëri mund të jetë një pengesë për rritjen e performancës së biznesit, megjithatë, në kushte të krahasueshme të normave tatimore, ekonomia e Serbisë po performon shumë më mirë duke treguar që elementë tjerë janë domethënës në rezultatet e performancës. Ndërto mund të klasifikohen kapitali njerëzor, performanca institucionale, infrastruktura, Sofistikimi i tregjeve dhe njohuritë në teknologji për të cilat Shqipëria duhet të orientojë politika efektive për të arritur vendet e rajonit dhe rritur performancën ekonomike në afatgjatë. Për më tepër, Shqipëria vazhdon të mbetet në një nivel të lartë të perceptimit të korrupsionit dhe po shkëputet nga trendi përmirësues i këtij treguesi tek vendet e tjera të rajonit. Në aspektin e barrës së taksave në ekonomi, duhet theksuar që Shqipëria, edhe pse me norma më të larta tatimore, arrin të sigurojë të ardhura nga taksat në buxhet më pak vendet e tjera në rajon (përfshirë Maqedoninë e Veriut). Ky fenomen mund të lidhet edhe me nivelin e lartë të përjashtimeve tatimore në Shqipëri dhe pse nuk gjendet një bazë krahasuese me vendet e rajonit për këtë tregues. Nëse përjashtimet tatimore në Shqipëri ruajnë parimin e nxitjes së prodhimit vendas nga biznesi, dhe ky instrument paralelizon nivelin e lartë të subvencioneve në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi, atëherë humbja e efektivitetit është e dyfishtë, në mungesën e të ardhurave tatimore dhe në rritjen e performancës së ekonomisë krahasuar me vendet e rajonit.

Në aspektin tregtar të mallrave, edhe pse Shqipëria ka rritur performancën në tregtinë rajonale, ky tregues ka vulnerabilitet të lartë nëse përfshijmë faktorët e sipërpërmendur të cilët rrisin riskun e performancës së avantazheve konkurruese me rajonin. Nëse krahasojmë performancën e tregtisë së jashtme të BP6 me performancën e tregtisë rajonale, kjo e fundit ka rritur volumin e saj shumë më pak se tregtia e jashtme e mallrave edhe pse CEFTA ka ndikuar pozitivisht në nxitjen e tregtisë në rajon. Nëse Serbia ka një avantazh të dukshëm në produktet ushqimore dhe Maqedonia e Veriut shpreh avantazh të dukshëm në “Produkte kimike dhe Plastike” si dhe në “Makineri dhe Pajisje”, për Shqipërinë avantazhi i vetëm shprehet në “Tekstike dhe veshmbathje” duke shfrytëzuar forcën e lirë punëtore. Bilanci tregtar negativ në mallra kompensohet në një masë me bilancin pozitiv në shërbime për Shqipërinë të lidhura kryesisht me sektorin e turizimit, por zgjerimi i shërbimeve sjell një faktor risku për ekonominë në rast krizash si ajo e covid-19 ku analiza e Malit të Zi e shpreh qartazi këtë fenomen. Në këtë kuptim, zgjerimi i sektorëve të shërbimeve duhet të jetë i balancuar midis rritjes dhe qëndrueshmërisë, në të kundërt faktorët e riskut shtohen. Problematika e tregtisë mallrave përfaqësohet me barrierat jo-tarifore, si ato sanitare dhe fitosanitare, teknike dhe administrative por edhe me keq orientimin e zhvillimit të sektorëve me intensitet të lartë karboni të cilat nuk janë në linjë me standartet e BE. Në tërësi BP6 duhet të ardesojë me vëmendje politikat e energjisë në të ardhmen duke kërkuar minimizimin e varësisë nga tregjet ndërkombëtare.

Ashtu si dhe BE thekson, rritja e ndërveprimit rajonal mund të sjell përfitime në vendet e rajonit por këto përfitime shoqërohen me risk të lartë nëse do të jenë gjithpërfshirëse apo selektive. Në këtë kuptim, hapja më thelluar tregtare me reduktimin e mëtejshëm të barrierave tregtare midis vendeve duhet të jetë e mirë studiuar dhe konsultuar gjerësisht dhe në çdo detaj me grupet e biznesit. Studime në nivel mikro për produkte të ndryshme duhet të merren në konsideratë me qëllim optimizimin e avantazheve krahasuese për çdo vend të cilat, në bashkëpunim me grupet e biznesit, duhet të jenë baza e trajtimeve specifike në marrëveshjet tregtare me rajonin. Vetëm në këtë mënyrë do të rritet besimi në shoqëri dhe në grupet e interesit duke ulur riskun moral dhe duke rritur premisat e kuptimit dhe kalimit të çdo situatë rastësore me risk në proces. Elementi i besimit, shoqëruar me komunikim efektiv dhe transparent rrit shpejtësinë e implementimit të politikave pasi grupet e interesit i mirëpresin ato për efektet e pritshme pozitive.

8. Shtojcë: Analiza kërkimore sasiore

Vendet e BP6 janë vende drejt zhvillimit dhe popullsia rezidente totale është rreth 17.5 milionë banorë me një trend rënës gjatë 30 viteve të fundit duke shfaqur edhe krizën demografike të rajonit. Të gjitha vendet e BP6 janë klasifikuar si vende me të Ardhura të Mesme të Larta⁴ sipas treguesit të PBB për frymë të publikuar nga Banka Botërore (BB) pavarësisht diferencave midis tyre. Vendet e BP6 kanë një nivel të lartë të popullsisë që jeton nën 5.5 USD/ditë për frymë, ku bie në sy diferenca e madhe që Shqipëria ka me vendet e tjera të rajonit, 31.8 % e popullsisë, e ndjekur nga Kosova me 20.9 %.

Me firmosjen e MSA çdo vend ka pranuar të instalojë bazën e instrumentave juridikë dhe institucionalë drejt “Acquis Communitaire” të BE duke drejtuar politikën kombëtare në këtë drejtim. MSA ka parashikuar edhe Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë (MTL) midis BE dhe çdo vendi kandidat të BP6 duke parashikuar një fazë tranzitore në eliminimin e barrierave tarifore dhe jo-tarifore në tregtinë e BP6 me BE. Ka disa përjashtime në produktet bujqësorë dhe produktet e peshkut, të cilat janë subjekt i kufizimeve preferenciale. Periudha tranzitore është në forcë vetëm me Kosovën deri në vitin 2026.

Duke ndjekur specifikat lokale Mali i Zi dhe Kosova kanë dekretuar si para kombëtare Euron ndërkohë që vendet e tjera kanë preferuar të ruajnë një politikë monetare bazuar mbi paranë vendase duke e përdorur si instrument më të shpejtë në efektivitetin e politikave ekonomike.

Tabela 2 përfaqëson informacionin për çdo vend në terma të PBB për Frymë, popullsinë, statusin aktual të MTL me BE, normën e popullsisë që jeton me më pak 5.5USD në ditë si dhe paranë kombëtare sipas kursit të këmbimit me euron.

Tabela 2 Informacion për BP6

Treguesit e përgjithshëm	Shqipëria (ALB)	Bosnja-Hercegovina (BIH)	Kosova (KOS)	Mali i Zi (MNE)	Maqedonia e Veriut (MKD)	Serbia (SRB)
PBB për Frymë 2019 (current USD)	5,355	6,120	4,445	8,910	6,022	7,411
Popullsia, 2019	2,854,191	3,300,998	1,788,878	622,028	2,083,458	6,908,224
Periudha tranzitore e heqjes së barrierave tarifore, BE vs. PB6	Përfunduar	Përfunduar	Deri në 2026	Përfunduar	Përfunduar	Përfunduar
Norma e Popullsisë që jetojnë nën 5.5 USD në ditë (PPP 2011), Viti 2019	31.8	Na	20.9	14.5	16.9	17.3
Paraja kombëtare dhe kursi i këmbimit, 12.2021	Lek (0.0082 euro)	Marka/BAM (0.5112 euro)	Euro	Euro	Dinar i MKD (0.016 euro)	Dinar i RSB (0.0085 euro)

⁴ Upper Middle Income

8.1. Rritja ekonomike, ndarja sektoriale, produktiviteti dhe tregu i punës

Rritja ekonomike e rajonit të PB6 pritet të rimëkëmbet pas krizës së vitit 2020 ku të gjitha vendet kanë pësuar rritje ekonomike negative. Duke ju referuar periudhës 2013-2019, në terma mesatarë, PB6 ka pasur rritjen më të lartë në vitin 2018 me 4.01% dhe një reduktim në 3.57% për vitin 2019, edhe pse më e lartë se 3.18% e vitit 2017. Ndërkohë Kosova duket se ka performuar më mirë se vendet e tjera gjatë periudhës 2013-2019 dhe pritet për vitin 2021 e kthejnë mbi mesataren e pritshme të rajonit. Disa specifika vihen në dukje mbi performancën e rritjes ekonomike. P.sh, Mali i Zi ka pasur rritje të konsiderueshme gjatë periudhës 2017-2019, duke shënuar dhe normën më të lartë të rritjes me 5.08% për vitin 2018, më e larta e konstatuar për të gjitha vendet gjatë periudhës 2013-2019. Megjithatë, pandemia e ka prekur shumë më tepër se vendet e tjera pasi vendi ka një nivel të lartë shërbimesh të lidhura me sektorin e turizmit duke shënuar dhe rënien më të lartë në PBB reale me -15.2% për vitin 2020.

Një specifikë tjetër vihet re edhe tek Serbia. Gjatë vitit 2018 dhe 2019 vendi ka pasur rritje më të lartë se mesatarja e rajonit, ndërkohë që pandemia ka ndikuar vetëm me një rënie ekonomike prej -0.98%, e cila është edhe rënia më e ulët në rajon. Gjatë vitit 2021 Serbia pritet t'i kthehet ritmeve të larta të rritjes me 6.54%. Në vendet e tjera, efekti bazë i vitit 2020 bën të kuptueshëm rritjen e pritshme pozitive në 2021. Ky efekt duket i papërfillshëm për Serbinë. Maqedonia e Veriut, pas një tkurrje graduale të rritjes deri në vitin 2017 ka recuperuar gjatë periudhës 2018-2019 dhe pse vendi nuk pritet të recuperojë gjatë vitit 2021 pasojat e krizës 2020. Shqipëria ka pasur një rritje graduale të treguesit deri në vitin 2018 ku është dhe vlera më e lartë prej 4.08%, ndërkohë thyerja e fortë e vitit 2019 në gati përgjysmim të rritjes nuk mund të shpjegohet vetëm nga goditja e tërmetit të 26 Nëntor 2019. I njëjti trend mund të vihet re edhe tek Bosnja-Hercegovina e cila ka pësuar rritje të treguesit deri në nivelin maksimal të 3.74% në vitin 2018, dhe më pas reduktim në vitin 2019 në shifrën e 2.83%. Ky vend pritet të shënoj dhe rritjen më të ulët për vitin 2021 duke treguar se efektet e pandemisë do të duhet të recuperohen në periudhat pasrëndëse. Të dhënat janë paraqitur në Tabelën 3.

Tabela 3 Treguesi i rritjes ekonomike për BP6

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021*
ALB	1.00	1.77	2.22	3.32	3.80	4.07	2.17	-3.31	5.30
BIH	2.35	1.15	3.09	3.15	3.18	3.74	2.83	-4.33	2.80
KOS	3.44	1.22	4.10	4.06	4.23	3.81	4.94	-5.30	6.00
MNE	3.55	1.78	3.39	2.95	4.72	5.08	4.06	-15.20	7.00
MKD	2.93	3.63	3.86	2.85	1.08	2.88	3.17	-4.53	4.00
SRB	2.89	-1.59	1.78	3.34	2.10	4.50	4.25	-0.98	6.54
Mesatare	2.69	1.33	3.07	3.28	3.18	4.01	3.57	-5.61	5.27

Burimi: FMN, 2021

Për të kuptuar edhe strukturën e prodhimit, kush janë sektorët më kontribues në PBB e vendit është analizuar periudha 2016-2019. Në këtë analizë vihet re asimetria e parë në pjesëmarrjen e

lartë me 18.9% që ka sektori Bujqësor në Vlerën e Shtuar Bruto (VSHB) në Shqipëri, më e larta krahasuar me vendet e tjera. Kjo pjesëmarrje është dyfish më e lartë se mesatarja e rajonit. Ndërkohë Serbia është vendi me pjesëmarrjen më të lartë të sektorit të Industrisë Përpunuese me 14.5% e ndjekur nga Maqedonia e Veriut dhe Bosnja-Hercegovina me 12.9%. Në sektorin e Shërbimeve, Mali i Zi ka një pjesëmarrje në VSHB me rreth 59.4%, më e larta në rajon e ndjekur nga Bosnja-Hercegovina me 55.4% dhe Maqedonia e Veriut me 54.4%. Në sektorin e Industrisë Nxjerrëse & Ndërtim, Kosova ka pjesëmarrjen më të lartë në rajon me 27.3% të VSHB e ndjekur nga Serbia me 25.7% dhe Maqedonia e Veriut me 24.0%. Të dhënat janë paraqitur në Tabelën 4.


Tabela 4 Pjesëmarrja sektoriale (%) në Vlerën e Shtuar Bruto, mesatare 2016-2019

2016-2019	ALB	BIH	KOS	MNE	MKD	SRB
Bujqësia	18.9	5.9	7.3	6.9	8.4	6.3
Industria&Ndërtimi	20.8	23.9	27.3	15.6	24.0	25.7
Ind. Përpunuese	6.1	12.9	3.8	3.8	12.9	14.5
Shërbimet	47.7	55.4	45.8	59.4	54.4	50.9

Burimi: BB, 2021

Ekonomia informale deri në vitin 2019 zë rreth 35% të PBB për të gjitha vendet e rajonit, duke përfshirë Serbinë, e cila ka reduktuar me rreth 5 pikë përqindje këtë pjesëmarrje gjatë periudhës 2015-2019 duke arritur në rreth 30% të PBB. Kjo pjesëmarrje informale vihet re me rreth 35% edhe në tregun e punës në Shqipëri, Bosnja-Hercegovinë dhe Mali i Zi, ndërsa Serbia dhe Maqedonia e Veriut paraqesin një normë më të ulët në rreth 20% të PBB. Kosova ka informalitetin më të lartë në rajon për këtë tregues dhe vlerësohet mbi 35% të PBB (BB,2021).

Grafiku 1 Produktiviteti për të punësuar si dhe paga mesatare, viti 2019



Burimi: BB, WIIW, 2021


Analiza e produktivitetit për punonjës merr në konsideratë PBB e vitit 2019 (PPP, çmime konstante 2017 USD) pjesëtuar për numrin e të punësuarve në ekonomi (15+), si dhe paga mesatare në USD për vitin 2019. Baza e të dhënave “World Outlook Indicators” e BB nuk ofron të

dhëna mbi këtë tregues për Kosovën dhe vlerësimet alternative për këtë vend nuk krijonin një bazë të mirë krahasimi. Ndërkohë për nivelin e pagës mesatare është përdorur baza e të dhënave “WiiW” të shprehura në Euro dhe më pas është konvertuar me kursin mesatar të Euro/USD për 2019.

Nga analiza e Grafikut 1 shihet qartë se paga mesatare dhe PBB për person të punësuar ruajnë përgjithësisht të njëjtin trend në diferencat midis vendeve. Shqipëria është dhe vendi me produktivitetin dhe pagën mesatare më të ulët në rajon. Diferencat në produktivitetin për të punësuar midis Bosnje-Hercegovinës, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut janë të papërfillshme, ndërkohë që paga mesatare për Bosnje-Hercegovinën është dukshëm më e lartë se në dy vendet e tjera. Niveli më i lartë i produktivitetit si dhe paga mesatare vihet re në Malin e Zi.

Arsyja pse Shqipëria ka produktivitetin më të ulët në rajon mund të shpjegohet me pjesëmarrjen e lartë të sektorit bujqësor në ekonomi. Megjithatë një analizë më e gjerë e tregut të punës dhe pagave mund të qartësojë edhe më shumë analizën sasiore. Edhe pse Kosova ka nivelin më të lartë të informalitetit në tregun e punës, Shqipëria është vendi ku nëndeklarimi i pagave është më i lartë gjatë periudhës 2016-2019 (SELDI, 2020). Vlerësohet se rreth 34% e të punësuarve në Shqipëri nëndeklarojnë pagën dhe 12% e tyre nuk zotërojnë një kontratë pune edhe pse me rënie gjatë periudhës në monitorim. Vlera të larta të nëndeklarimit përfaqëson edhe Bosnja-Hercegovina me 31% dhe Serbia me 30%. Ndërkohë që për Maqedoninë e Veriut nëndeklarimi i pagës vihet re në 19% të punësuarve, niveli më i ulët në rajon si dhe vetëm 9% të punonjësve deklarojnë pa një kontratë. Fenomeni i nëndeklarimit të pagës është i ulët edhe në Kosovë me rreth 19% por punonjës pa kontratë pune vlerësohen mbi 25% të totalit. Niveli më i ulët i punonjësve pa kontratë gjendet në Bosnja-Hercegovinë me vetëm 4% dhe më pas Serbia me 7% të totalit të të monitoruarve.

Grafiku 2 Dinamika e pagës mesatare në BP6 gjatë periudhës 2012-2019




Burimi: WiiW, 2021

Gjatë harkut kohor 2012-2019Q2 niveli mesatar i pagës nominale është rritur në të gjithë rajonin megjithatë Shqipëria mbetet me nivelin më të ulët të saj të deklaruar. Vendet me pagën mesatare më të lartë në BP6 janë Mali i Zi e ndjekur nga Bosnja-Hercegovina. Dallimet në pagën mesatare midis Serbisë, Maqedonisë Veriut dhe Kosovës janë të vogla dhe pse Serbia ka nivelin më të lartë në vitin 2019. Për më shumë informacion mbi dinamikat e pagës mesatare të deklaruar jepet në Grafikon 2.

Norma e papunësisë në Kosovë vijon të mbetet e lartë dhe dukshëm mbi mesataren e rajonit, ajo shënon 26.2% të forcave të punës sipas statistikave zyrtare kombëtare. Për vitin 2019 vetëm Serbia paraqet një normë papunësie nën 10%, e cila ndiqet nga Shqipëria me 11.7%. Për vendet e tjera të BP6 papunësia mbetet e lartë pavarësisht diferencave në metodën e vlerësimit. Normat e papunësisë për PB6 gjatë vitit 2019 paraqiten në Grafikon 3.


Grafiku 3 Norma e papunësisë sipas statistikave kombëtare dhe ILO, viti 2019



Burimi: BB, 2021

Një specifikë për të kuptuar rezultatet e tregut të punës është edhe statusi i punësimit midis të vetëpunësuarit dhe të punësuarit me pagesë. Niveli i lartë i të vetëpunësuarve në Shqipëri mund të lidhet edhe me nivelin e ulët të pagës mesatare.

Grafiku 4 Struktura e të punësuarve, viti 2019



Burimi: BB, 2021

Pavarësisht nivelit të produktivitetit, të vetëpunësuarit, përgjithësisht, deklarojnë pagën minimale në sistem për efekt taksash dhe të kontributeve. Nga ana tjetër, niveli i lartë i të vetëpunësuarve mund të lidhet edhe nivelin e ulët të produktivitetit në Shqipëri. Të dhënat për Kosovën nuk janë të disponueshme në Grafikon 4, ku jepen dhe përqindjet e totalit të të punësuarve midis të vetëpunësuarve dhe të punësuarve me pagesë.

8.2. Dallimet në Financat Publike, të Ardhurat dhe Shpenzimet dhe Borxhi Publik⁵

Gjatë periudhës 2016-2019, Serbia është vendi që realizon më shumë të ardhura buxhetore në nivelin 47.41% të PBB e ndjekur nga Bosnja-Hercegovina me 42.82% të PBB dhe Mali i Zi me 41.20% të PBB. Vendet e tjera, Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Kosova realizojnë të ardhura buxhetore më pak se 30% të PBB. Kosova është vendi që realizon më pak të ardhura buxhetore në nivelin 26.67% të PBB dhe të ardhurat nga taksat shënojnë 24.56% të PBB. Ky është një tipar dallues për këtë vend pasi 92% të të ardhurave vijnë nga taksat, ndërkohë që Serbia dhe Bosnja-Hercegovina realizojnë rreth 53.1% të ardhurave buxhetore nga taksat. Maqedonia e Veriut duket vendi që ka barrën tatimore më ulët në rajon duke realizuar vetëm 18.44% të PBB të ardhura nga taksat e ndjekur nga Shqipëria me 19.28%, ndërkohë Serbia është vendi me barrën tatimore më të lartë me 25.14% të PBB. Duhet theksuar se përjashtimet tatimore në Shqipëri arrijnë rreth 5.7% të PBB dhe nuk evidentohet informacion me bazë krahasimore me vendet e tjera të BP⁶.

Bosnja-Hercegovina realizon 17.83% të PBB të ardhura nga TVSH, niveli më i lartë në rajon ndërkohë që Maqedonia e Veriut realizon vetëm 7.57% të PBB nga TVSH. Serbia ka barrën më të lartë tatimore tek individët duke realizuar të ardhura me 3.95% të PBB e ndjekur nga Maqedonia e Veriut me 2.62% të PBB, ndërkohë për vendet e tjera ky tregues është nën 2% të PBB. Përsa i përket akcizës, Kosova mban dhe nivelin më të lartë me 6.37% të PBB e ndjekur nga Serbia me 5.96% të PBB. Varësia e lartë nga produktet i importit në Kosovë është një shpjegim i nivelit të lartë të të ardhurave nga tjo taksë, ndërkohë që Serbia realizon të ardhurat nga kjo taksë kryesisht nga hidrokarburet me mbi 50%, rreth 37% nga duhani dhe pjesa e mbetur nga të tjera (Ministra e Financave, Serbi 2021).

Duket qartë diferenca e madhe që ka Shqipëria tek të ardhurat nga taksa mbi automjetet me 1.10% të PBB, e ndjekur nga Kosova më 0.48% të PBB. Ndërkohë Maqedonia e Veriut realizon të ardhura nga kjo taksë vetëm 0.03% të PBB. Për të ardhurat nga kontributet shoqërore Bosnja-

⁵ Për të kuptuar diferencat në të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore të Qeverisë së Përgjithshme përfshin Qeverinë Qendrore, Qeverinë Lokale dhe Qeverinë Shtetërore, është shfrytëzuar baza e të dhënave të FMN. Ka disa dallime në metodologji midis klasifikimit lokal dhe të FMN. Ky shembull duket shumë i dukshëm në rastin e Serbisë, megjithatë jep një bazë të mirë krahasimi midis vendeve. Të dhënat për Malin e Zi nuk janë të disponueshme në databazën e FMN për "Government Finance Statistics". Të dhëna për këtë vend gjenden vetëm bazën e të dhënave të "Fiscal Monitor" të FMN.

⁶ Në një studim të Gligorov dhe Simolov (2021) vlerësohet se përjashtimet tatimore në Maqedoninë e Veriut janë rreth 3% të PBB.

Hercegovina është e para me 15.07% të PBB e ndjekur nga Serbia me 12.2% të PBB, ndërkohë që Shqipëria realizon vetëm 5.50% të PBB në këtë tregues. Tek të ardhura të tjera Serbia realizon një vlerë shumë më të lartë se vendet e tjera me rreth 9.47% dhe ky tregues i jep mundësinë e menaxhimit të të ardhurave të përgjithshme përtej normave tatimore të aplikuara. Ndërkohë mbetet e paqartë pse Kosova nuk ka të klasifikuar të ardhura nga kontributet shoqërore. Të dhënat përfaqësuese janë paraqitur në Tabelën 5.

Tabela 5 Të Ardhurat buxhetore në përqindje të PBB, mesatare 2016-2019

Nr.		ALB	BIH	KOS	MKD	SRB
	Të Ardhurat e Përgjithshme	27.29	42.82	26.67	29.47	47.41
1	Nga Taksat	19.28	22.77	24.56	18.44	25.14
1.1	Mbi të ardhurat, fitimin dhe kapitalin	4.05	3.57	3.47	4.50	6.14
1.1	<i>Nga individët</i>	1.92	1.83	1.71	2.62	3.95
1.1	<i>Nga korporatat dhe ndërmarjet</i>	2.13	1.74	1.76	1.88	2.19
1.2	Taksa mbi pronën	0.41	0.37	0.38	0.22	0.80
1.3	Taksa mbi të mirat dhe shërbimet	14.38	18.69	18.74	12.58	17.35
1.3.1	<i>Tatimi mbi Vlerën e Shtuar</i>	8.64	17.83	11.17	7.57	9.97
1.3.2	<i>Akciza</i>	2.82	0.35	6.37	3.76	5.96
1.3.3	<i>Taksa nga automjetet</i>	1.10	0.09	0.48	0.03	0.21
1.3.4	<i>Të tjera</i>	1.82	0.41	0.72	1.22	1.22
1.4	Taksa të tjera	0.43	0.14	1.96	1.14	0.85
2	Nga Kontributet shoqërore	5.50	15.07	-	7.83	12.12
3	Grante	0.71	0.17	0.23	0.68	0.67
4	Të Ardhura të Tjera	1.80	4.81	1.89	2.53	9.47

Burimi: FMN, 2021

Në analizën e shpenzimeve të përgjithshme vihet re edhe pjesëmarrja e sektorit shterëror në ekonomi. Bazuar edhe tek të ardhurat e përgjithshme, WB6 ndahet në dy grupe, vende me pjesëmarrje të lartë si: Mali i Zi me 46.44% të PBB, Bosnia Hercegovinë me 42.27% të PBB dhe Serbia me 41.16% të PBB, dhe vende me pjesëmarrje të ulët në ekonomi si: Maqedonia e Veriut me 31.17% të PBB, Shqipëria me 29.12% të PBB dhe Kosova me 28.80% të PBB. Pagat dhe shpërblimet e punonjësve të administratës janë më të ulta në Shqipëri me 5.89% të PBB ndërkohë që Bosnja-Hercegovina shpenzon 10.08% në këtë tregues.

Shpenzimet për subvencione janë më të larta në Maqedoninë e Veriut me 2.30% e ndjekur nga Serbia me 2.19%, ndërkohë që Shqipëria realizon vetëm 0.13% të PBB në subvencione, rreth 17 herë më pak se këto vende. Politikat e subvencionimit në Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë janë më të orientuara drejt sektorit privat ndërkohë që Serbia ka më tepër fokus në sektorin publik. E krahasuar me të ardhurat nga kontributet shoqërore, Bosnja-Hercegovina ruan më mirë balancën në raport me shpenzimet për përfitimet shoqërore. Vendi realizon të ardhura 15.07% të PBB (Tabela 5) dhe shpenzime 15.21% të PBB (Tabela 6) duke mbajtur dhe një nivel të lartë të asistencës sociale me 3.48% të PBB. Niveli më i lartë i shpenzimeve për përfitimet shoqërore jepet nga Serbia më 16.19% të PBB dhe më i ulëti përfaqësohet me Kosovën në 6.14% të PBB, ndërkohë që Maqedonia e Veriut ka dhe hendekun më të lartë midis të ardhurave për kontributet

dhe përfitimeve shoqërore me rreth 7.04% të PBB. Në këtë aspekt, vendet shfaqin dhe nevojën e përbashkët ndaj reduktimit të informalitetit në punësim për të menaxhuar skemat e pensioneve dhe nën presionin e reduktimit të popullsisë dhe rritjes së moshës mesatare ky menaxhim duhet të jetë prioritet. Nëse do të shtojmë dhe pritshmëritë për lëvizjen e lirë të fuqisë punëtore në rajon, ndërthurja e skemave të pensioneve midis vendeve të BP6 merr vëmendje të shtuar. Të dhënat janë paraqitur në Tabelën 6.

Tabela 6 Shpenzimet buxhetore në përqindje të PBB, mesatare 2016-2019

Nr.		ALB	BIH	KOS	MKD	SRB
	Shpenzimet e Përgjithshme	29.12	42.27	28.80	31.17	41.16
	Shpenzime sipas zërave⁷	23.52	37.95	21.58	29.16	43.21
1	Kompensimi i punonjësve	6.85	10.60	8.96	6.58	9.85
1.1	<i>Pagat dhe shpërblimet</i>	5.89	10.08	8.11	6.57	8.30
1.2	<i>kontribute shoqërore të punonjësve</i>	0.96	0.52	0.85	0.01	1.56
2	Përdorimi i të mirave dhe shërbimeve	2.92	7.22	3.79	3.24	6.93
4	Shpenzimet për interesin	2.21	0.74	0.31	1.22	2.44
5	Shpenzimet për subvencione	0.13	1.39	1.60	2.30	2.19
5.1	<i>Për Korporatat Publike</i>	0.05	0.67	0.49	0.14	1.18
5.2	<i>Për Korporatat Private</i>	0.07	0.72	1.10	2.03	0.38
5.3	<i>Për sektorë të tjerë</i>	0.01	0.00	-	0.14	0.64
6	Shpenzime për grante	0.09	0.01	0.09	0.12	0.10
7	Shpenzime për përfitimet shoqërore	10.07	15.21	6.14	14.87	19.65
7.1	<i>Për sigurimet shoqërore</i>	7.62	11.62	-	13.21	16.19
7.2	<i>Për asistencën sociale</i>	2.45	3.48	6.12	1.66	3.09
7.3	<i>Përfitime të lidhura me të punësuarit</i>	0.00	0.11	0.02	-	0.38
8	Shpenzime të tjera	1.25	2.77	0.69	0.84	2.04

Burimi: FMN, 2021

Kriza e Covid-19 ka impaktuar edhe balancat fiskale të çdo vendi të BP6 duke ndikuar edhe në rritjen e borxhit publik. Sipas projeksioneve të FMN, vendi me borxhin më të lartë publik deri në fund 2021 është Mali i Zi me 93.40% të PBB, i ndjekur nga Shqipëria me 81.47% të PBB. E impaktuar edhe nga Plani i Rindërtimit, Shqipëria projektton edhe nivelin më të lartë defiqitar në 6.69% të PBB ndërkohë që defiqiti buxhetor në Serbi projektohet në 6.51% të PBB e kushtëzuar edhe nga paketa e lartë e masave antikrizë që vendi aplikoi duke arritur një nivel borxhi publik në 59.85% të PBB.

⁷ Diferenca midis Shpenzimeve të Përgjithshme dhe Shpenzime sipas zërave qëndron në mos-përfshirjen e Investimeve kapitale të financuara nga buxheti qendror, amortizimi i tij si dhe të ardhurat që mund të vijnë nga të ardhura të tjera në pronësi të shtetit. Për më shumë qartësi ndiq shpjegimin metodologjik të FMN për klasifikimin <https://data.imf.org/?sk=a0867067-d23c-4ebc-ad23-d3b015045405&slid=1390288795525>. P.sh, Serbia është klasifikuar me nivel më të lartë të shpenzimeve sipas zërave se shpenzimet totale edhe pse vendi deklaroi shpenzime kapitale rreth 3.7% të PBB gjatë periudhës 2016-2019.

Tabela 7 Projektionet për Borxhin Publik dhe Balancën Buxhetore për vitin 2021

2021*	ALB	BIH	KOS	MNE	MKD	SRB
Të Ardhurat e Përgjithshme	27.33	41.58	27.32	43.32	29.68	41.43
Shpenzimet e Përgjithshme	34.02	44.83	32.11	48.31	35.60	47.94
Balanca Totale	-6.69	-3.25	-4.78	-4.98	-5.92	-6.51
Balanca Primare	-4.47	-2.51	-4.41	-2.45	-4.61	-4.61
Borxhi Publik (Bruto)	81.47	38.93	25.77	93.40	52.95	59.85

Burimi: FMN, 2021

Kosova paraqitet me nivelin më të ulët të borxhit publik në rajon, në nivelin 25.77% e ndjekur nga Bosnja Hercegovina me 38.93% të PBB, ndërkohë që Maqedonia e Veriut tregon se borxhi publik projektohet në 52.95% të PBB. Sipas BB (2021), të ardhurat e përgjithshme pritet të rekuperohen gjatë 2021 vetëm për Shqipërinë dhe Serbinë, ndërsa vendet e tjera duhet të presin për më tej. Të dhënat për borxhin publik dhe balancën buxhetore në vitin 2021 janë të paraqitura në Tabelën 7.

8.2.1. Normat tatimore në BP6

Rezultatet në buxhet janë edhe si rezultat i politikave tatimore mbi normat e taksave në çdo vend. Arsyet pse të ardhurat nga kontributet janë të larta në Bosnja-Hercegovinë kuptohen nga norma e lartë e kontributeve shoqërore në nivelin 41.5%, më e larta në rajon. Gjithashtu, të punësuarit në këtë vend mbajnë dhe barrën më të lartë të kontributeve shoqërore në rajon në nivelin 31% të ndjekur nga Maqedonia e Veriut me 28%. Specifika e Maqedonisë së Veriut është tek barra e kontributeve shoqërore e cila i mbetet totalisht të punësuarit. Edhe pse Shqipëria ka normë të lartë të TVSH në 20%, të ardhurat buxhetore sipas kësaj takse tregojnë se Shqipëria ka performancë të ulët në arkëtim. Një specifike e Shqipërisë është niveli i lartë i përjashtimeve tatimore që në vitin 2019 arrinte në 5.7% të PBB dhe mbi 95% të përjashtimeve vjen nga TVSH.

Tabela 8 Normat tatimore për vitin 2021

	ALB	BIH	KOS	MNE	MKD	SRB
Taksa mbi të Ardhurat e Korporatës	15.00	10.00	10.00	9.00	10.00	15.00
Taksa mbi të Ardhurat Personale	13/23.00	10.00	10.00	9.00	10.00	10/20
Taksa mbi të Ardhurat nga Kapitali	15.00	10.00	10.00	9.00	10.00	10.00
TVSH bazë	20.00	17.00	18.00	21.00	18.00	20.00
Kontributet Shoqërore	24.50	41.50	10.00	32.30	28.00	36.55
<i>Për kompaninë</i>	15.00	10.50	5.00	9.30	-	16.65
<i>Për të punësuarin</i>	9.50	31.00	5.00	24.00	28.00	19.90
Taksat dhe kontributet si % e fitimit (2019)	36.60	23.70	13.00	22.20	13.00	36.60
Numri i pagesave për Taksat (2019)	35	33	10	18	7	33

Burimi: Tradingeconomics & BB, 2021

Të dhënat e disponueshme nuk ofrojnë bazë krahasuese me vendet e tjera të rajonit. Shqipëria dhe Serbia përfaqësojnë me barrën më të lartë tatimore për një sipërmarrës. Me të dhënat e vitit 2019, përqindja e taksave dhe kontributeve në raport me fitimin është 36.6%, ndërkohë që për

Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën ky tregues është vetëm 13%. Shqipëria duket më problematike në rajon në raport me taksat pasi ka dhe numrin më të lartë të pagesave. Ato arrijnë në 35 pagesa brenda një viti fiskal.

8.3. Kreditimi i sektorit bankar dhe tregues të tjerë lidhur me sistemin bankar për BP6

Funksionimi i sektorit bankar nxit performancën e ekonomisë në disa drejtime duke alokuar burimet financiare, duke vlerësuar projektet që duhet të financojnë këto burime si dhe menaxhimi i kostove financiare të tyre. Referuar Tabelës 8, Shqipëria mbetet nën mesataren e BP6 nga pikëpamja e përdorimit të sistemit bankar për kreditim. Në vitin 2013, Në Shqipëri vetëm 12.3% e firmave përdorin sistemin bankar për financim të investimeve ndërkohë që në vitin 2019 ky tregues rezulton i përmirësuar në 21.5%, por ende nën mesataren e rajonit. Specifika e Malit të Zi, i cili ka ulur përqindjen e firmave që përdorin sistemin bankar si në Investime dhe në kapital qarkullues duhet analizuar edhe me tregues të tjerë, ndërkohë që Serbia duket vendi që financon më shumë firma si për Investime por edhe për kapital qarkullues.

Tabela 9 Firmat që përdorin sistemin bankar në përqindje të totalit, viti 2013 vs. 2019

	Financim për Investime		Financim për kapital qarkullues	
	2013	2019	2013	2019
ALB	12.4	21.5	23	30.4
BIH	44	34	45.3	40.4
KOS	33.3	34.2	55.8	53.1
MNE	34.6	15.8	42.8	26
MKD	29.3	35.4	42.8	38.6
SRB	32.9	39.4	47.4	51
Mesatarja BP6	31.1	30.1	42.9	39.9

Burimi: BB, 2021

Ecuria e huave me probleme ka ardhur në rënie për të gjitha vendet e BP6 edhe pse Shqipëria mbetet vendi me nivelin më të lartë. Gjatë periudhës 2016-2019, huatë me probleme në Shqipëri rezultojnë mesatarisht në 12.8% të totalit të stokut të huasë, ndërkohë që për vitin 2020 ky tregues shënon 8.1%.

Kosova mbetet vendi me nivelin më të ulët tek ky tregues por me pjesëmarrjen më të lartë të të huajve në pronësinë e sistemit bankar. Huatë me probleme në Maqedoninë Veriut dhe Serbi për vitin 2020 shënojnë 3.4% dhe 3.7% , më ulët se mesatarja e rajonit. Rritja mesatare e kreditimit me 1.2% dhe depozitave me 1.1% në sistemin bankar gjatë periudhës 2016-2019 për Shqipërinë tregon për një performancë të ulët gjatë kësaj periudhe, ndërkohë që për vitin 2020 këta tregues janë më mirë se mesatarja e rajonit. Rritja e kreditimit dhe depozitave ka përformuar më mirë në Kosovë gjatë periudhës 2016-2019 dhe ky trend shihet edhe gjatë vitit 2020 megjithëse Serbia ka nivelin më të lartë të rritjes së kreditimit dhe depozitave për vitin 2020. Edhe pse me nivelin më të lartë të kredive me probleme dhe me nivelin më të ulët të rritjes së kreditimit, treguesi i ROE

në Shqipëri është mbi mesataren e rajonit gjatë 2016-2019. Për më shumë analizë të dhënat gjenden në Tabelën 10.


Tabela 10 Tregues të sistemit Bankar gjatë periudhës 2016-2020

Treguesi	Huatë me probleme ndaj totalit të stokut të huajve		Pronësia e të huajve në sistemin bankar		Rritja e kreditimit		Rritja e depozitave		ROE	
	2016-2019	2020	2016-2019	2020	2016-2019	2020	2016-2019	2020	2016-2019	2020
ALB	12.8	8.1	80.8	69.4	1.2	6.6	1.1	8.3	12.3	10.7
BIH	9.5	6.1	84.3	83.2	4.9	1.1	9.7	5.6	9.4	6
KOS	3.2	2.7	87.6	86.5	10.7	7.1	9.7	11.5	20.1	14
MNE	7.3	5.5	72.7	81.3	6.5	3.2	7.4	-3	6.9	3.6
MKD	5.7	3.4	71.7	75.0	6.5	4.1	7.3	6.2	13.7	11.3
SRB	9.2	3.7	76.2	86.0	5.7	11.9	9.6	17.5	8.7	11.3
Mesatar e BP6	7.9	4.9	78.9	80.2	5.9	5.7	7.5	7.7	11.9	9.5

Burimi: KE, 2021

Niveli i kredisë drejt sektorit privat⁸ në Shqipëri vijon të mbetet më i ulëti në rajon. Në vitin 2020 ky tregues shënon 38.7% të PBB ndërkohë që niveli maksimal vihet re në Malin e Zi me rreth 60% të PBB. Në Grafikon 5 janë paraqitur niveli mesatar i kredisë së brendshme drejt sektorit privat për periudhën 2012-2015 si dhe 2016-2019. Edhe në këtë rast vihet re që Shqipëria ka nivele të ulta të kreditimit krahasuar me vendet e tjera. Rritja e kreditimit në vitin 2020 tek të gjitha vendet e BP6 ka ardhur edhe si rezultat i masave anti-krizë megjithëse kjo situatë mund të ndikojë negativisht me rritjen e huave me probleme gjatë periudhave në vijim.

Grafiku 5 Kredia e brendshme drejt sektorit Privat, në përqindje të PBB



Burimi: FMN, 2021

⁸ Duke përfshirë edhe kreditimin e ndërmarjeve të sektorit publik por jo kreditë e garantuara.

Shqipëria ka dhe nivelin më të ulët në rajon pas Kosovës për numrin e degëve të kankave tregtare që kryejnë aktivitetin në brenda territorit kombëtar për 100.000 të rritur. Referuar të dhënave të WOI, 2021 ky tregues duket me trend rënës në mesataren e rajonit. Në vitin 2010 mesatarja e rajoni PB6 shënon 30.9, ndërkohë që në vitin 2015 arrin në 28.5 dhe në vitin 2019 rreth 26.2 degë për 100.000 të rritur. Referuar Shqipërisë, për vitin 2020 ky tregues shënon 18.6 dhe i krahasuar me 38.1 për Malin e Zi, 29.9 për Bosnja-Hercegovinë dhe 23.1 për Maqedoninë e Veriut, ky tregues duke shumë më i ulët. Ndërkohë që për Serbinë në vitin 2019 ky tregues është rreth 29.7.

8.4. Sektori i Jashtëm, Tregtia, IHD, Llogaria Korrente dhe borxhi i Jashtëm

Hapja ekonomike ndaj lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve si dhe ndaj tregjeve të kapitalit është një faktor i rëndësishëm në analizën ekonomike. Për këtë arsye janë detajuar treguesit kryesorë; Tregtia e mallrave e cila merr fokus kryesor edhe ndërveprimin rajonal, Investimet e Huaja Direkte (IHD), si dhe burimet financiare që vendi qarkullon me pjesën tjetër të botës.

8.4.1. Tregtia e mallrave në BP6

Referuar të dhënave të “Atlas of Economic Complexity” të Universitetit të Harvardit është ndërtuar analiza krahasuese e tregtisë së mallrave midis vendeve të BP6. Duhet theksuar që ky burim të dhënash nuk përmban informacion për Kosovën. Përballur me këtë realitet, të dhënat për tregtinë e mallrave në Kosovë janë marr nga AKSK dhe më pas integruar me të dhënat e tjera. Ky proces rrit termin e gabimit në analizën krahasuese pasi metodologjia e përdorur nga databaza të ndryshme është e ndryshme, megjithatë besojmë se trendi mbetet i njëjtë.

Vendet e BP6 në tregtinë e mallrave gjatë vitit 2019 kanë realizuar 49.8% të PBB në importe dhe 33.1% të PBB në eksporte, nga të cilat vetëm 2.6% të PBB në importe dhe 4.1% në eksporte në tregtinë ndër-rajonale. Midis vendeve të PB6, Serbia është eksportuesi neto me vlerën më të lartë në 1.73 Miliardë USD. Vendet e tjera, Bosnja Hercegovina, Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut janë importues neto. Duhet theksuar që gjatë vitit 2019 Serbia dhe Bosnja-Hercegovina është prekur ekstremisht nga taksa 100% mbi importet në Kosovë, e lidhur me instrumentin e reciprocitetit nga Republika e Kosovës, në të kundërt, të dhënat mbi tregtinë e mallrave në rajon do të ishin të ndryshme në favor të eksporteve të Serbisë dhe Bosnja-Hercegovinës. Për të patur një ide, të dhënat e Agjencisë Kombëtare Statistikore të Kosovës (AKSK) tregojnë se gjatë vitit 2018 importet nga Serbia ishin në vlerën e 459 Milion USD dhe nga Bosnja-Hercegovina rreth 200 Milion USD. Kjo taksë u anulua në vitin 2020. Vlerat e tregtisë ndërrajonale në PB6 për vitin 2019 janë paraqitur në Tabelën 11.

Tabela 11 Tregtia ndërrajonale e mallrave në BP6, viti 2019

(000 USD)	ALB	BIH	KOS*	MNE	MKD	SRB	Balanca tregtare në WP6
-----------	-----	-----	------	-----	-----	-----	-------------------------

ALB	import	-	26,207	75,437	12,837	79,623	162,212	222,235
	eksport	-	21,259	250,677	48,317	77,479	180,819	
BIH	import	21,259	-	7,149	29,379	93,687	1,472,132	(586,414)
	eksport	26,207	-	2,407	214,307	75,698	718,573	
KOS*	import	250,677	2,407	-	32,011	269,427	6,476	(376,474)
	eksport	75,437	7,149	-	21,897	49,408	30,634	
MNE	import	48,317	214,307	21,897	-	34,782	831,051	(974,697)
	eksport	12,837	29,379	32,011	-	6,022	95,407	
MKD	import	77,479	75,698	49,408	6,022	-	748,160	(13,997)
	eksport	79,623	93,687	269,427	34,782	-	465,251	
SRB	import	180,819	718,573	30,634	95,407	465,251	-	1,729,347
	eksport	162,212	1,472,132	6,476	831,051	748,160	-	

Burimi: Atlas of Economic Complexity, AKSK, 2021, dhe përpunim i autorëve

Partneri kryesor i BP6 mbetet tregu i përbashkët i BE. Për vitin 2019, volumi tregtar (eksport+import) me BE është 66.2% e totalit të tregtisë së PB6, tregtia ndër-rajonale përfaqëson 12.7% dhe 21.1% e totalit të tregtisë është me pjesën tjetër të botës.

Tabela 12 Hapja dhe balanca tregtare si dhe import eksport sipas hapësirave gjeografike në përqindje të PBB, viti 2019

Vendi		Me BE-28	Ndërrajonale	Pjesa tjetër e botës	Hapja treg.	Balanca treg.	Raporti Eksp/Imp
ALB	import	22.71	2.33	12.23	55.91	-18.63	0.50
	eksport	14.17	3.78	0.68			
BIH	import	32.80	8.04	5.31	78.79	-13.50	0.71
	eksport	23.42	5.13	4.09			
KOS*	import	24.64	7.05	17.56	54.60	-43.85	0.11
	eksport	1.95	2.32	1.13			
MNE	import	28.22	24.07	10.10	72.12	-52.66	0.16
	eksport	3.65	3.68	2.41			
MKD	import	54.53	7.80	8.97	134.86	-7.74	0.89
	eksport	51.52	7.69	4.36			
SRB	import	33.57	2.81	11.98	84.77	-11.97	0.75
	eksport	23.67	6.08	6.65			

Burimi: Atlas of Economic Complexity, AKSK, 2021, dhe përpunim i autorëve

Në terma të hapjes tregtare, Maqedonia e Veriut përfaqëson nivelin më të lartë me 134.9% ndërkohë që balanca tregtare për këtë vend rezulton në -7.7% të PBB. Vendi ka realizuar eksporte 51.5% të PBB dhe importe 54.5% të PBB me BE-28. Mali i Zi dhe Kosova kanë deficitin më të madh tregtar në PB6, respektivisht me -52.7% dhe -43.8% të PBB. Mali i Zi realizon nivelin më të madh të importeve nga rajoni në nivelin 24.1% ndërsa Kosova është vendi me nivelin më të ulët të eksporteve totale dhe realizon vetëm 5.4% të PBB. Gjithashtu Kosova paraqet edhe nivelin më të ulët në rajon për raportin Eksport/Import në vlerën 0.11. Përsa i përket eksporteve me pjesën tjetër të botës Serbia realizon 6.65% të PBB, niveli më i lartë në rajon. Të dhënat për BP6 sipas

hapjes dhe balancës tregtare, import dhe eksport sipas hapësirave gjeografike si dhe raportit eksport/import janë paraqitur në Tabelën 12.

Krahas proceseve të përbashkëta midis vendeve të BP6 dhe BE duhet gjykuar edhe mbi dinamikat e tregtisë midis tyre. Si vit krahasues është përzgjedhur subjektivisht viti 2011 i cili mund të integruet i impaktit të MSA dhe pjesëmarrjes në CEFTA të vendeve BP6. Analiza krahasuese bazohet mbi të dhënat e vitit 2011 dhe 2019. Si rezultat i kufizimit i të dhënave në burim nuk është përfshirë Kosova në këtë analizë për këtë arsye është përdorur Treguesi BP5 në këtë pjesë të analizës.

Vendi me rritjen më të lartë të eksportit në tregtinë e mallrave vlerësohet Serbia me 69.6% të totalit të eksporteve për këtë vend, e ndjekur nga Maqedonia e Veriut me 66.1% dhe Shqipëria me 42.2%, ndërkohë që rritja më e lartë në importe vlerësohet të ketë ndodhur në Maqedoninë e Veriut me 52.7% të totalit të importeve për këtë vend, e ndjekur nga Serbia me 42.4% dhe Shqipëria me 21.8%. Në raport me tregtinë ndër-rajonale Shqipëria zë vendin e parë në rritjen e eksportit ndër-rajonal me 121.6% e ndjekur nga Serbia me 20.4%, ndërkohë që vendet e tjera, Maqedonia e Veriut, Bosnja-Hercegovina dhe Mali i Zi kanë reduktuar eksportet ndërrajonale. Maqedonia e Veriut është vendi që ka rritur më shumë eksportet me BE në vlerën 95.6% e ndjekur nga Serbia me 84.8% dhe Shqipëria me 42.2%. Një specifikë tjerër në këtë analizë është reduktimi i eksporteve për Malin e Zi me të gjitha hapësirat gjeografike, përjashtuar rritjen e konsiderueshme në eksporte me Maqedoninë e Veriut. Të dhëna më të detajuara gjenden në Tabelën 13.

Tabela 13 Krahasim 2019 vs. 2011 të tregtisë së mallrave për BP5 (rritja në %)

Vendi	ALB		BIH		MNE		MKD		SRB	
	Import	eksport	import	eksport	import	eksport	import	eksport	import	eksport
ALB			703	-49.60	209.50	-7.70	92.70	-9.20	102.10	-0.40
BIH	-49.60	702.70			4.20	-1.80	-16.60	-2.10	3.80	29.00
MNE	-7.70	209.50	-1.80	4.20			221.30	4.50	-14.00	-0.80
MKD	-9.20	92.70	-2.10	-16.60	4.50	221.30			-25.00	41.70
SRB	-0.40	102.10	29.00	3.80	-0.80	-14.00	41.70	-25.00		
Vendi vs. BP	-11.30	121.60	27.30	-0.60	3.30	-8.30	37.30	-19.60	-3.50	20.40
Vendi vs. BE-28	7.62	50.25	3.78	22.11	26.36	-42.75	61.91	95.56	36.52	84.78
Tregtia Total	21.80	42.20	4.20	17.10	13.60	-14.90	52.70	66.10	42.40	69.60

Burimi: Atlas of Economic Complexity, 2021, dhe përpunim i autorëve

Zgjerimi më i shpejtë i tregtisë së mallrave me BE vihet re kur krahasojmë rritjen me 39.1% të volumit tregtar në total për BP5 dhe rritjen e këtij volumi me 42.3% me BE-28. Për më tepër, importi i PB5 nga vendet e BE është rritur me 29% ndërsa eksporti është rritur me 65.8% duke sjell reduktim me 18% të defiçitit tregtar të mallrave me vendet e BE. Partnerët kryesorë në BE mbeten Gjermania me Italia me respektivisht 22.1% dhe 14.4% të volumit tregtar të mallrave të BP5 me BE për vitin 2019. Gjithsesi ky përmirësim i tregtisë nuk ka ndodhur me të njëjtin ritëm

midis BP5. Volumi tregtar ndërrajonal i BP5 në vitin 2019 krahasuar me 2011 është rritur me vetëm 11.1% ose vetëm 1.3 pikë përqindje më shumë se rritja e PBB nominale PB5⁹. Ky krahasim i thjeshtë por konkret tregon se është ende e kufizuar edhe pse CEFTA ka arritur rezultate konkrete në reduktimin e tarifave tregtare për vendet e BP. Mesa duket në mungesë të CEFTA vendet e BP do të ishin në nivele edhe më të ulta të tregtisë ndërrajonale.

Një analizë më e detajuar sipas nëngrupeve të mallrave qartazi pozicioni i Malit të Zi si importues neto në çdo nëngrup. Në grupin e produkteve “Ushqimi, pije dhe duhan” Serbia është eksportues neto, por me nivel të lartë eksporti rezulton edhe Maqedonia e Veriut dhe pse me bilanc negativ tek ky grup. Tek grupi “Energji, karburante edhe energji” të gjitha vendet janë importues neto.

Në grupin “Produkte kimike dhe plastike” vihet re pozicioni i lartë si eksportues neto i Maqedonisë së Veriut. Shqipëria, Bosnja-Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut janë eksportues neto në “Tekstile dhe veshmbathje”. Për Shqipërinë ky fenomen lidhet me zhvillimin e industrisë “fason” e cila ka shfrytëzuar avantazhin e pagave të ulta në vend. Bosnja-Hercegovina është eksportues neto në “Përpunimin e drurit dhe artikujt e letrës” që nuk evidentohet tek vendet e tjera. Megjithatë, Serbia ka nivel të përafërt të importit dhe eksportit në këtë grup dhe pse me rezultat negativ.

Tabela 14 Tregtia ndërkombëtare sipas grupeve kryesore në përqindje të PBB, viti 2019

Tregtia e Mallrave sipas nëngrupeve kryesore	ALB		BIH		MNE		MKD		SRB	
	imp	exp	imp	exp	imp	exp	imp	exp	imp	exp
Ushqim, Pije dhe Duhan	5.4	1.6	7.7	2.2	13.3	1.1	6.4	5.4	4.3	6.8
Energji, karburante edhe energji	4.8	2.6	5.6	3.0	7.9	2.3	8.0	3.6	6.1	1.9
Produkte kimike dhe plastike	4.5	0.4	7.7	3.9	8.3	1.1	9.1	15.5	8.5	5.5
Përpunimi i Lëkurës	1.0	0.2	0.9	0.4	0.3	0.0	0.4	0.1	0.5	0.3
Përpunimin e drurit dhe artikujt e letrës	1.4	0.5	1.9	2.9	2.3	0.9	1.8	0.3	1.9	1.6
Tekstile dhe veshmbathje	4.9	7.6	4.3	5.1	3.3	0.1	5.3	5.8	2.8	2.5
Materiale ndërtimi dhe metale	4.4	2.0	5.9	5.9	8.1	2.5	21.3	6.8	5.9	5.2
Makineri dhe Pajisje	6.7	1.0	10.0	5.6	15.1	1.0	15.8	22.4	15.0	10.4
Të tjera	4.2	2.8	2.2	3.6	3.8	0.7	2.8	3.5	3.8	2.7
Balanca Tregtare (në % të PBB)	-18.6		-13.6		-52.7		-7.7		-12.0	

Burimi: Atlas of Economic Complexity, 2021, dhe përpunim i autorëve

Në grupin “Materiale ndërtimi dhe metale” Bosnja-Hercegovina ka të njëjtin nivel të importit me eksportin si dhe Serbia ka një balancë negative të ulët. Ndërkohë vihet re niveli i lartë i importit tek ky grup me 21.3% të PBB për Maqedoninë e Veriut. Në mungesë të këtij grupi produktesh Maqedonia e Veriut do të ishte eksportues neto në totalin e tregtisë së mallrave.

⁹ Sipas PBB me çmime korente në USD sipas të dhënave të Bankës Botërore, rritja nominale e PBB për vitin 2019, krahasuar me vitin 2011 rezulton 9.8%.

Grupi më specifik është “Makineri dhe Pajisje”. Maqedonia e Veriut rezulton eksportues neto dhe ka një nivel të lartë eksporti prej 22.4% të PBB. Serbia dhe Bosnja Hercegovinë, dhe pse importues neto, kanë gjithashtu eksporte të larta krahasuar me Shqipërinë dhe Malin e Zi. Maqedonia e Veriut është dhe vendi që rezulton në katër nëngrupe si eksportues neto, specifikë që nuk evidentohet tek vendet e tjera. Tabela 14 ofron informacion më të detajuar.

8.4.2. Disa nga problematikat e tregtisë së mallrave të PB6

Ka arsye të ndryshme pse tregtia ndër-rajonale është zhvilluar më pak se tregtia e përgjithshme ndërkombëtare, një prej tyre mund të jetë struktura e ekonomisë dhe tregjet e segmentuara. Megjithatë, janë identifikuar pengesat dhe kërcënimet më të mundshme për zhvillimin e ardhshëm. Në aspektin teknik, Komisioni Evropian¹⁰ (KE, 2018) arrin në përfundimin se problematika kryesore në tregtinë ndërrajonale të BP-së mbeten barrierat jotarifore në tre kategori kryesore: i) pengesat teknike në tregti, ii) masat sanitare dhe fitosanitare, iii) pengesat administrative të tregtisë. Çështje të tjera të konsideruara janë kostot e larta të kohës së konsumuar në procedurat e eksportit që mund të jenë shumë herë më të larta se vendet e Evropës Lindore me BE-në. Më tej, kostoja e transportit për njësi e BB-së është rreth 232 USD ndërkohë që për vendet e Evropës Lindore është vetëm 34 USD¹¹.

Konfliktet etnike nuk kontribuojnë në bashkëpunimin rajonal dhe prosperitetin e përbashkët të BB. Më tej, ndërhyrja politike në ekonomi dhe kapja e shtetit nga interesi privat ul kapacitetet administrative, të fajësuar për mungesën e konkurrencës dhe mosfunksionimin e tregut dhe institucionit, dhe nuk e fokuson sektorin privat në Kërkim dhe Zhvillim, gjë që përkeqëson bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet agjencive qeveritare (KE, 2018).

Eksportet e BP6 gjatë dekadës së fundit kanë ruajtur nivel të lartë të sektorëve me intensitet karboni, jo në përputhje me politikat e tregut të BE-së (Banka Botërore, 2021). Për këtë arsye këto vende duhet të ndërmarrin iniciativa dhe politika konkrete drejt investimit në ekonominë e gjelbër. Kjo mundësi do të rrisë produktivitetin dhe inovacionin e këtyre ekonomive, me synim një vëllim të lartë të tregtisë me BE-në në të ardhmen e afërt. Një karakteristikë tjetër është se performanca e eksporteve pengohet nga produktiviteti i dobët, investimet e ulëta në sektorët e orientuar drejt eksporteve dhe lidhjet e dobëta ndërmjet sektorëve të IHD-ve dhe ekonomisë lokale (OECD, 2021).


8.4.3. Llogaria Korente dhe IHD

¹⁰ European Commission (2018), Untapped Potential: Intra – Regional Trade in the Western Balkans, Discussion paper, ISSN 2443-8022 online

¹¹ https://ec.europa.eu/commission/commissioners/2014-2019/hahn/announcements/speech-johannes-hahn-western-balkans-six-leaders-summit_en

Nga pikëpamja e analizës së marrëdhënieve ekonomike dhe financiare të vendit me pjesën tjetër të botës merret në konsideratë Bilanci i Pagesave, i cili balancon dy llogaritë kryesore; Llogaria Korente dhe Llogaria e Kapitalit Financiar. Në këtë kuptim analiza e Llogarisë Korente na bën të kuptojmë edhe nevojat që kasur vendi për financime të huaja në ekonominë vendase.

Grafiku 6 Llogaria korente në përqindje të PBB ndër vite për PB6



Burimi: BB, 2021


Llogaria Korente përmban bilancin tregtar të mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga faktorët si dhe transferta të tjera (jo-financiare ose për llogari të kapitalit) që në rastin e vendeve të BP identifikohen në një pjesë të mirë me remitancat. Pozicioni i Llogarisë Korente kompensohet me pjesën tjetër të bilancit të pagesave që pëfaqësohen kryesisht me IHD dhe burimet e tjera financiare.

Duke krahasuar tre periudha; 2008-2011, 2012-2015 dhe 2016-2019, përgjithësisht vendet e BP6 kanë reduktuar defiçitin e Llogarisë Korente si përqindje ndaj PBB, duke përjashtuar rritjen e dukshme për Malin e Zi. Ky vend është me nivelin më të lartë të defiçitit në Llogarinë Korente, ndërkoë që Maqedonia e Veriut me nivelin më të ulët të saj gjatë gjithë periudhës së marr në konsideratë. Defiçiti i Llogarisë Korente të Malit të Zi është më shumë se dy herë më i lartë se mesatarja e rajonit. Dinamika e Llogarisë Korente për vendet e BP6 paraqitet në Grafikon 7.

IHD janë dhe një tregues i kapacitete përthithëse të investitorëve të huaj në vend që përgjithësisht orientohen tek përmirësimet leknologjike, metodat novatore të prodhimit dhe menaxhmit, si dhe investimet strategjike të vendit kur vendi nuk ka kapacitete të tilla. Referuar të dhënave Mali i Zi mban rekordin e IHD-ve në përqindje të PBB në rajon për të gjithë periudhën kohore të marrë në konsideratë edhe pse me trend rënës. Gjatë periudhës 2016-2019 Serbia dhe Maqedonia e Veriut paraqiten me trend rritës të IHD-ve krahasuar me periudhën pararendëse, ndërkoë që Shqipëria dhe Kosova kanë ulur nivelin e IHD-ve në ekonomi. Gjithsesi, Shqipëria, gjatë periudhës 2016-2019, ka mbajtur një nivel të lartë të IHD krahasuar me vendet e tjera të

rajonit. Niveli më i ulët i IHD-ve për periudhën e marr në konsideratë paraqitet nga Bosnia Hercegovinë. Dinamika e IHD-ve në vendet e BP6 është paraqitur në Grafikon 7.

Grafiku 7 Investimet e Huaja Direkte (hyrjet neto) në përqindje të PBB ndër vite për PB6



Burimi: BB, 2021

8.4.4. Borxhi i jashtëm

Borxhi i jashtëm përbëhet nga borxhi i sektorit publik dhe i borxhi i sektorit privat. Borxhi i sektorit publik është totalisht i garantuar tek vendet e BP6 dhe ai përmban edhe borxhin e jashtëm të huazuar nga Qeveria Qendrore. Nga të dhënat për vitin 2020 vihet re se Mali i Zi është vendi më problematik në borxhin e jashtëm. Ky tregues është më shumë se dyfish i PBB¹², shumë më i lartë se vendet e tjera të rajonit. Specifika të tjera mund të vihen re në këtë analizë. P.sh, Maqedonia e Veriut është vendi që ka diferencën më të madhe midis borxhit publik të garantuar dhe të Qeverisë Qendrore në borxhin e jashtëm. Kjo diferencë është rreth 9% e PBB i ndjekur nga Mali i Zi me rreth 5% të PBB. Shqipëria rezulton me vetëm 2.64% të PBB për këtë tregues. Edhe pse Kosova ka nivelin më të ulët të borxhit të Jashtëm, ky vend ka nivelin më të lartë të diferencës midis sektorit privat dhe sektorit publik në favor të këtij të fundit. Ky fenomen vihet re edhe tek Bosnja Hercegovinë, ndërkohë që për vendet e tjera diferencat janë më pak të evidentueshme. Për më shumë detajime jepet Tabela 15.

Tabela 15 Përbërja e borxhit të jashtëm në vitin 2020, në përqindje të PBB

¹² Në statistikat e borxhit të jashtëm përdoret përqindja ndaj GNI (Të Ardhurat Kombëtare Bruto). Për efekt njëtrajtësimi me treguesit e tjerë të marr në konsideratë në këtë punim është përdorur PBB. Megjithatë, për vendet e BP6 diferencat midis PBB dhe GNI janë relativisht të ulta.

	Borxhi I Jashtëm, Total (A+B)	Publik i Garantuar (A)	Qeveria Qendrore	Sektori Privat (B)
ALB	72.94	35.45	32.81	37.49
BIH	71.51	26.15	24.28	45.35
KOS	40.28	6.70	6.05	33.58
MNE	203.84	101.84	96.89	101.99
MKD	86.49	41.60	32.56	44.89
SRB	72.12	34.40	32.74	37.73

Burimi: FMN, 2021

8.5. Të Bësh Biznes dhe Novacioni

Indeksi “të bësh biznes” i BB klasifikon mbi 190 vende të botës duke ofruar një matës objektiv për planin regullativ të biznesit për çdo vend sipas dhjetë nëndarjeve kryesore. Në këtë indeks janë përfshirë edhe vendet e BP6.

Për vitin 2020, Maqedonia e Veriut është vendi që klasifikohet më mirë në këtë tregues. Sipas renditjes totale të 190 vendeve, Maqedonia e Veriut renditet në vendin e 17, në grupin e 10% vendeve me performancën më të mirë dhe indeksi është përmirësuar nga 80.65 për vitin 2019 në 80.75 në vitin 2020. Vendi me performancën më të mirë pas Maqedonisë së Veriut renditet Serbia, ndërkohë që Shqipëria dhe Bosnja-Hercegovina janë vendet me performancën më të ulët në PB6. Tabela 16 jep të dhëna më të detajuara për klasifikimin dhe vlerën e indekstit si renditja e çdo vendi sipas dhjetë nëndarjeve të indekstit për vitin 2020. Çdo vlerë e hijëzuar me të kuqe përfaqëson renditje më të ulët se mesatarja e BP6 dhe hijëzimet me ngjyrë jeshile renditje më të lartë se mesatarja e BP6. P.sh, Shqipëria renditet në vendin e 166 tek nëndarja “Marrja e lejes së ndërtimit” dhe mesatarja e BP6 është 94. Kjo analizë mund bëhet për çdo tregues të paqitur në Tabelën 16.

Tabela 16 Indeksi “të bësh biznes” dhe renditja për çdo nëndarje të tij në vitin 2020

	ALB	BIH	KOS	MNE	MKD	SRB	Mesatarja BP6
Renditja në vitin 2020	82	90	57	50	17	44	57
Indeksi në vitin 2020	67.75	65.44	73.18	73.82	80.75	75.65	72.77
Indeksi në vitin 2019	67.00	65.37	71.05	73.71	80.65	73.92	71.95
1. Të fillosh një biznes	53	184	12	101	78	73	84
2. Marrja e lejes së ndërtimit	166	173	160	40	15	9	94
3. Marrja e energjisë	107	75	90	134	69	94	95
4. Regjistrimi i pasurisë	98	96	37	83	48	58	70
5. Marrja e kredisë	48	67	15	15	25	67	40
6. Mbrojtja e minoritetit	111	88	128	61	12	37	73
7. Të paguash taksat	123	141	48	75	36	85	85
8. Tregtia jashtë kufijve	25	27	31	41	32	23	30
9. Përmbartimi i kontratave	120	93	53	44	47	65	70
10. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve	39	37	48	43	30	41	40

Burimi: BB, 2021

Nga pikëpamja e inovacionit së vendeve është konsideruar “Indeksi i Inovacionit Global” për vitin 2021 të publikuar nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO). Raporti përmban të dhëna për 132 vende të botës¹³. Ky indeks ka shtatë nëndarje kryesore.

Tabela 17 Indeksi i Novacionit Global dhe renditja për çdo nëndarje të tij në vitin 2021

	ALB	BIH	MNE	MKD	SRB	Mesatarja BP5
Renditja 2021	84	75	50	59	54	64.4
Renditja 2020	83	74	49	57	53	63.2
1. Institucionet	60	82	48	52	50	58.4
2. Kapitali Njerëzor dhe Kërkimi	90	68	59	73	62	70.4
3. Infrastruktura	62	62	60	49	44	55.4
4. Sofistikimi i Tregjeve	79	61	41	12	58	50.2
5. Sofistikimi i Biznesit	68	99	67	65	63	72.4
6. Njohuritë dhe Outputet Teknologjike	103	66	78	57	43	69.4
7. Outputet Krijuese	81	99	33	83	76	74.4

Burimi: WIPO, 2021

Referuar të dhënave në Tabelën 17 vihet re nënie e të gjithë vendeve në renditjen e përgjithshme duke kaluar nga një renditje mesatare për 2020 në 63.2 tek 64.2 për vitin 2021. Mali i Zi është vendi me renditjen më të mirë tek ky indeks i ndjekur nga Serbia dhe Maqedonia e Veriut, më pas Bosnja-Hercegovina dhe në fund Shqipëria. Renditja sipas çdo nëndarje për vitin 2021 është paraqitur në Tabelën 17. Të gjitha vlerat e hijëzuara me të kuqe përfaqësojnë renditje më të ulët se mesatarja e rajonit, dhe e kundërta, vlerat e hijëzuar me jeshile përfaqësojnë renditje më të lartë se mesatarja e rajonit. Shqipëria, tek nëndarja “Njohuritë dhe outputet teknologjike” renditet në vendin e 103 nga 132 vende, renditje shumë më e ulët se mesatarja e rajonit. Shqipëria renditet më mirë se mesatarja e rajonit vetëm tek “Sofistikimi i Biznesit” por kjo mesatare influencohet shumë nga renditja e ulët e Bosnja-Hercegovinës. Tregues tjetër problematik për Shqipërinë janë “Kapitali Njerëzor dhe Kërkimi” si dhe “Sofistikimi i Tregjeve” ku renditja është më e ulta në rajon. Për më shumë analizë mund të ndiqet Tabela 17.


Një burim tjetër informacioni për të krahasuar stokun e njohurive prodhuese tek një vend është dhe “Indeksi i Kompleksitetit Ekonomik” i Universitetit të Harvard. Ky tregues bazohet në diversitetin e eksporteve që vendi prodhon dhe e krahason me vendet që mund ta realizojnë kë të produkt. Sa më i lartë sofistikimi i njohurive aq më i lartë është kapaciteti për të prodhuar produkte të shumëllojshme dhe komplekse që pak vende mund ta realizojnë. Në këtë klasifikim janë renditur 133 vende.

Edhe në këtë tregues Shqipëria ka performancë më të ulët se vendet e tjera të BP. Për vitin 2019 Shqipëria renditet në vendin e 83 ndërkohë që Serbia në vendin e 34. Duke zgjatur harkun kohor të analizës vihet re që Shqipëria jo vetëm ka performancën më të ulët nga vendet e klasifikuara

¹³ Kosova nuk është e klasifikuar në këtë raport.

në rajonin e BP, por kjo performancë ka një rend në ulje gjatë periudhës 2009-2019, fenomen që nuk vihet tek vendet e tjera të BP të klasifikuara në këtë indeks. Në vitin 2009 Shqipëria renditet në vendin e 81 kundrejt 133 vendeve. Mesatarja e renditjes vjetore për periudhën 2009-2019 për Shqipërinë shënon 82 dhe në vitin 2019, e përmendur edhe më sipër, Shqipëria renditet në vendin e 83. Vendi me performancën më të mirë historike në rajonin e BP renditet Serbia ndërkohë që Maqedonia e Veriut është vendi që ka përmirësuar më shumë performancën në renditje, nga 72 në vitin 2009 ka arritur në 58 për vitin 2019. Të dhënat dhe trendi i tyre për indeksin janë paraqitur në Grafikon 8.

Grafiku 8 Renditja në Indeksin e Kompleksitetit Ekonomik, periudha 2009-2019



Burimi: Atlas of Economic Complexity, 2021

Referenca

Almeida, R., & Fernandes, A. M. 2008. Openness and technological innovations in developing countries: Evidence from Firm-Level Surveys.

Ballkan insights, 2022, <https://balkaninsight.com/2022/01/18/montenegro-being-urged-to-join-risky-open-balkan-initiative-analyst/>

Barro, R. J., & Sala-i-Martin, X. 1997. Technological diffusion, convergence, and growth. *Journal of Economic Growth*, 2(1), 1–26. available at: <https://doi.org/10.1023/A:1009746629269> [Access Date: 03.12.2021]

CEFTA 2021. Common Regional Market 2021-2024, Action Plan. Available at, <https://cefta.int/wp-content/uploads/2020/11/Common-Regional-Market-2021-2024-Action-Plan.pdf> [Access Date: 03.12.2021]

Chamber of Investment Forum for Western Balkan 6, 2021. Monitoring the Implementation of the Common Market Action Plan 2021-2014: Key Business Insights on Priority Action Points, Co-founded by the European Union, <https://www.wb6cif.eu/2021/12/07/presentation-of-the-second-report-monitoring-the-implementation-of-the-common-regional-market-action-plan-2021-2024-key-business-insights-on-priority-action-points/>

Do, T. Q., Levchenko, A. A., 2006. Trade, inequality, and the Political Economy of Institutions, Policy Research Paper No.3836, World Bank.

Dollar, D., & Kraay, A. 2004. Trade. *Growth and Poverty. Economic Journal*, 114, 22–49.

European Commission, 2018. Supporting an Innovation Agenda for Western Balkan, tools and Methodologies. Publications Office of the European Union, Luxembourg, ISBN 978-92-79-81870-7, doi:10.2760/48162.

European Commission, 2018. Untapped Potential: Intra – Regional Trade in the Western Balkans, Discussion paper, ISSN 2443-8022 online, Luxembourg: Publications Office of the European Union

European Commission, 2021. Economic and Investment Plan for the Western Balkans, Directorate General for Neighbourhood and Enlargement Negotiations, <https://www.wbif.eu/sectors/connectivity-agenda>

European Commission, 2021. Economic Reform Programmes...The Commission's Overview and Country Assessments, Institutional Paper 158

Freund, C., & Bolaky, B. 2008. Trade, regulations, and income. *Journal of Development Economics*, 87, 309–321. Available at: <https://doi.org/10.1016/j.jdeveco.2007.11.003> [Access Date:03.12.2021]

Gligorov, Z., Simonov, J., 2021. Tax Expenditures Report: The case of the Republic of North Macedonia, 9th International Workshop on Domestic Revenue Mobilization

Hausmann, R., Hwang, J., Rodrik. D., 2006. What you export matter, *Journal of Economic Growth* 12:1-25. Available at, https://ucu.edu.uy/sites/default/files/facultad/fce/economia/articulos/HausmannRodrikwhatyouexportmatters_2007.pdf [Access Date: 03.12.2021]

Ministry of Finance of Republic of Serbia, 2022, <https://www.mfin.gov.rs/en/documents2-2/current-macroeconomic-development-presentation-2>

OECD, 2021. Multi-dimensional Review of the Western Balkans: Assessing Opportunities and Constrains. Available at, <https://www.oecd.org/dev/multi-dimensional-review-of-the-western-balkans-4d5cbc2a-en.htm> [Access Date: 03.12.2021]

Sakyi, D., Villverde, J., Maza. A., Chittedi, R. K., 2021. Trade openness, Growth and Development: Evidence from heterogeneous panel cointegration analyses for middle-Income Countries, Cuadernos de Economía 31. 57. Available at, http://www.scielo.org.co/scielo.php?script=sci_arttext&pid=S0121-47722012000200002 [Access Date: 03.12.2021]

World Bank, 2019. Rising Uncertainty, Western Balkans Regular Economic Report, No.16, Fall 2019, World Bank Group

World Bank, 2021. Greening the Recovery, Regular Economic Report No.20, Fall 2021. Available at, <https://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/western-balkans-regular-economic-report> [Access Date: 04.12.2021]

World Bank, 2021. Subdued Recovery, Regular Economic Report No.19, Spring 2021, World Bank Group

Disa nga nismat rajonale: Këshilli për Bashkëpunimin Rajonal (RCC); Komunitet (Vëzhguesi) i Transportit Evropian Jug-lindor (SEETO); Komuniteti i Energjisë (EnC); Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA); Zyra për Bashkëpunimin Rajonal të të rinjve (RYCO), Nisma e Anti-korrupsionit Rajonal (RAI); Forumi i Dhomës së Investimeve të BP (WBCIF); Fondi i BP (WBF).